

UNITED NATIONS
United Nations
Interim
Administration
Missionin Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

KUVENDI I KOSOVËS СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

BULETINI

Shkurt, 2004 Nr.4



Kryeparlamentari Daci takohet me z.Solana

DACI: Na duhet mbështetje më e madhe e bashkësisë ndërkombëtare

SOLANA: Dokumenti për operacionalizimin e standardeve duhet të ndihmohet me miratimin e ligjeve bazike nga Kuvendi i Kosovës



Takimi Daci - Solana

Viti 2004 është vit shumë i rëndësishëm për Kosovën, sepse mbahen zgjedhjet e dyta parlamentare për Kosovë, ndaj duhet të implementohen standardet, është shprehur Përfaqësuesi i lartë BE-së për siguri dhe politikë të jashtme, Javier Solana, në takimin me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci. Në këtë vështrim ai e ka quajtur tepër të rëndësishëm aktivitetin më intensiv të Kuvendit në miratimin e legjislationit bazik për Kosovën.

Në takim me z. Solana, të cilin e shoqëronin këshilltarët e tij dhe shefi i Shtyllës IV të UNMIK-ut, Nikollas Llambdsdorf, kryeparlamentari Daci ka theksuar faktin se Kosovës i duhet mbështetje më e madhe e bashkësisë ndërkombëtare në planin politik dhe ekonomik dhe në këtë dritë ka vlerësuar raportet e partneritetit me UNMIK-un dhe ka kërkuar që sa të përfaqësohet Kosova para institucioneve ndërkombëtare, të marrin pjesë edhe përfaqësuesit e institucioneve të zgjedhura të vendit.

Profesor Daci është shprehur se Kuvendi i ka dhënë mbështetje të plotë qeverisë për të gjitha gjërat që kanë të bëjnë me implemtimin e standardeve dhe se ligjet në Parlamentin e Kosovës miratohen me procedurë të shpejtë.

Kryediploti evropian, Solana, është angazhuar për një zgjidhje pragmatike lidhur me çështjen e ngritur të piktuarave në holin e Kuvendit. Në ndërhyrjen e këshilltarit të tij, Stefan Lehne, se Kuvendi do të ballafaqohet me bojkotimin e deputetëve serbë, sepse pikturat plotësuese të bashkësive të tjera etnike në Kosovë, nuk mund të bëhen shpejt, profesor Daci është përgjigjur:

”shpejt mund t’i blejmë pikturat e gatshme”, nëse deputetët e koalicionit “Kthimi” tregojnë gatishmëri për ta evituar problemin.



PËRMBAJTTJA:

Buxheti i konsoliduar i Kosovës në tërësi do të financohet nga të hyrat vetjake..... 3

Përvojë e mirë në funksionimin e pushtetit legjislativ, ekzekutiv e përfaqësues..... 7

Përkushtim më i madh për përmbushjen e standardeve..... 9

Interes i ndërsjellë për bashkëpunimin Kosovë-Shqipëri dhe për integrimet kombëtare e ndërkombëtare..... 14

U përurua salla Kuvendit të Kosovës..... 12

Projekte konkrete për mbështetje të Kuvendit të Kosovës.....14

Redaksia:

Sharif Konufca, Shefqet Rexhepi, Celal Ilyas, Edona Fetahu

Telefonat Kontaktues:

038\ 211 186, 038\ 211 949, 038\ 211 189, 044\ 127 921

Tel/Fax: **038 211188**

E-mail:

media@assembly-kosova.org

Web faqja:

www.assembly-kosova.org

Buxheti i konsoliduar i Kosovës në tërësi do të financohet nga të hyrat vetjake

Kuvendi i Kosovës ka shqyrtuar Projektligjin për buxhetin vjetor të konsoliduar të Kosovës dhe përvetësimet për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2004 dhe e ka aprovuar atë. Prezentimin e ligjit para deputetëve e ka bërë ministri i Ekonomisë dhe Financave, z. Ali Sadriu. Z. Sadriu theksoi se këtij ligji i është dhënë një prioritet i veçantë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe në Qeveri, përgjithësisht.

Ligji mbi përvetësimet buxhetore është baza juridike për çdo vit fiskal, përmes të cilit vihet në dukje se cili institucion e ka hartuar buxhetin, nga të cilat të hyra do të krijohet buxheti, cili është niveli i përgjithshëm i këtij buxheti, cilave organizata buxhetore u dedikohet ky buxhet, cilat janë politikat operuese të buxhetit dhe prioritetet e tyre, cilat janë kompetencat, por edhe përgjegjësitë për mosoperimin apo operimin jo të drejtë të proceseve buxhetore.

Procedurat e operimeve buxhetore që ne po i bëjmë tani janë përcaktuar me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, sipas të cilave janë zhvilluar edhe proceset buxhetore të cilat sollën deri te përpilimi i këtij buxheti.

Buxhet i harmonizuar me prioritetet në të gjitha nivelet

Kam kënaqësinë t'ju bëj me dije se për përpilimin e Buxhetit 2004 është realizuar një punë e madhe profesionale dhe e përgjegjshme. Janë kryer një varg takimesh, shumë debate dhe shumë sygjerrime, shumë sfida të dhimbshme pasi që është dashur të heqen shumë projekte të vlefshme për të sotmen dhe të ardhmen e Kosovës, në mungesë të mjeteve të cilat nuk do t'i kemi.

Projekti i Buxhetit i prezentuar ka marrë në konsideratë shumë prioritetet të mundshme të përcaktimeve nga Qeveria e Kosovës. Me punën e madhe të bërë, është arritur që për herë të parë të realizohet përpilimi i Buxhetit nga institucionet vetëqeverisëse të Kosovës që dëshmon për një të arritur të madhe profesionale



Ali Sadriu

dhe të përgjegjshme të këtyre institucioneve. Kjo nuk do të ishte e mundshme të arrihej sikur të mos ekzistonte mirëkuptimi dhe përgjegjësia e të gjithë shfrytëzuesve të mjeteve buxhetore. Andaj, si rezultat kemi një Projektbuxhet të harmonizuar me prioritetet tona në të gjitha nivelet. Pra, për herë të parë e bëjmë këtë pasi që kemi pajtim të plotë të organizatave buxhetore, si në nivelin qendror, ashtu edhe në nivelin lokal. Kemi pasur pajtimin e shfrytëzuesve të mjeteve buxhetore të të gjitha nacionaliteteve. Kemi pasur, po ashtu, pajtim të plotë edhe nga organizatat buxhetore të pjesës së rezervuar.

Ne si Qeveri kemi marrë një oblig-

Investimet për vitin 2004 parashihen të jenë 607 milionë euro, në vend të 632 milionë euro sa ishin në vitin 2003. Po e vëreni se kemi një rënie për 25 milionë, që është rezultat i faktit se për herë të parë ne startojmë me buxhet vetjak pa grante të donatorëve.

im për një trajtim me prioritet që do t'u bëjmë disa projekteve që prezen-tohen nga pjesa e rezervuar, por që, gjithsesi gjatë trajtimit të suficitit ato do t'i nënshtrohen procedurës normale. Po ceku, se ne nuk kemi problem me KEK-un. Ne kemi problem me projektet që mund të paraqiten nga KEK-u, me madhësinë e tyre, prandaj edhe po them se ne kemi marrë atë, por do ta trajtojmë në nivele përkatëse të Komisionit të buxhetit, të Qeverisë e do të vijë edhe në Parlament.

Këtë e bëj, sepse kam informacione se ka ardhur këtu një letër që, në një mënyrë e kërkon këtë marrje të përgjegjësive publike.

Si rezultat i punës së shkëlqyer, ky Projektpropozim është përkrahur nga Qeveria, nga të gjitha strukturat e Këshillit Ekonomik Fiskal dhe në mënyrë mjaft afirmative nga Fondi Ndërkombëtar Monetar.

Sipas Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive është dashur që para jush të prezen-toj buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Por, fatkeqësisht, ne sot prezentojmë vetëm Buxhetin e përgjithshëm të Kosovës, sepse nuk disponojmë me të dhënat financiare për ndërmarrjet publike, dhe sipas Ligjit mbi menaxhimin e financave publike ato janë të obliguara. Mjerisht, në Ligj nuk figurojnë masat ndëshkuese që i obligojnë. Ky është një obligim që ne e kemi marrë, do ta ndërrojmë dhe do t'i vëmë masat ndëshkuese për të gjithë ata që nuk i sjellin. Por, procesin buxhetor ajo nuk e ndërrohet. Është një tablo që ne, dhe përgjithësisht Kuvendi dhe Qeveria duhet ta

/ vijon në faqe 4 /

kenë një qasje dhe njohje për të gjitha ato procese. Andaj, do të doja që institucionet e përgjegjësishë për këtë segment të kryejnë detyrën në pajtueshmëri me ligjin, kurse ne, në të ardhmen, duhet ta aprovojmë një amendament që do të sanksionojë domosdoshmërisht raportimin e financave nga ndërmarrjet publike.

Pritet një rritje modeste e brutoproduktit vendor

Në vijim ministri Ali Sadriu foli për indikatorët makroekonomik me të cilët karakterizohet Buxheti fiskal i vitit 2004. Kosova, me rreth 2 milionw banorë karakterizohet me moshën më të re, e cila sillet rreth moshës 24 vjeçare. Kjo është një përparësi e madhe. Kosova ka shkallë shumë të ulët vjetërsie, me vetëm 6% të popullatës mbi 65 vjet. Vjetërsia si dihet është ngarkesë edhe për vendet e zhvilluara në Perëndim që sillet rreth 50% dhe më shumë. Pra, edhe ky është një prioritet për Kosovën.

Në anën tjetër, Kosova ka një shkallë shumë të lartë të papunësisë, e cila sillet diku mbi 50%. Në bazë të analizave, rezultojnë se për Buxhetin e vitit 2004 pritët një rritje modeste e brutoproduktit vendor. Brutoprodukti vendor në vitin 2003 ka qenë 1.232 miliard euro, apo është shtuar për 2.5%, ndërsa në vitin 2004 do të jetë 1.248 miliard euro, apo 1.4 më i lartë se në vitin 2003. Në material është përvjedhur një gabim teknik rreth kësaj përqindjeje, prandaj do të vlejnjë këto përqindje dhe do t'i korrigjojmë gjatë procedurave.

Brutoprodukti vendor për banor, gjatë vitit 2004 do të jetë 703 euro për kokë, që është më i lartë se në vitin 2003. Pritët një ulje e kënaqshme e çmimeve, andaj qytetarët për të njëjtat para do të mund të blejnë më tepër mallra dhe shërbime.

Në vitin 2004 pritët një shkallë më e madhe dhe më e efektshme e shpenzimeve buxhetore. Pritët të ketë një zvogëlim të importit, por në të njëjtën kohë do të ketë shkallë më të

madhe të të hyrave nga taksat.

Konsumi i tërësishëm për vitin 2004 parashihet të jetë 2.6 miliardw euro, kundruall 2.7 miliardw euro sa ishte në vitin 2003.

Netoeksporti për 2004 parashihet të jetë minus 1.8 miliard euro deri në 1.9 miliard euro. Shkallja e inflacionit ka pasur tendencë të rënies dhe vazhdon me këtë. Ajo, derisa në



vitin 2001 ka qenë 12.2%, në vitin 2002 ka rënë në vetëm 2.9%, ndërkaq për vitin 2004 parashihet të mos ketë inflacion, apo edhe një deflacion i lehtë do të vërehet. Kosova edhe më tutje nuk ka të drejtë të emitojë para dhe të bëjë huazime publike. Kjo nënkupton se duhet të jemi gjithëherë të kujdesshëm dhe të kemi një buxhet të qëndrueshëm.

Duke dhënë një tabllë të buxhetit për vitin 2004, ministri Sadriu theksoi se të hyrat nga donatorët do të jenë 80 milionë euro. Për vitin 2003 ishin 53.2 milionë euro, apo 26.8 milion euro më tepër se parashikimet për buxhetin 2003. Kjo është si rezultat edhe i parashikimeve joadekuate gjatë vitit 2003.

Të ardhurat nga akticizat do të jenë 158 milionë euro dhe do të jenë më të larta për 34 milionë euro, krahasuar me vitin që po e lëmë pas.

Të hyrat nga TVSH-ja në import do të jenë 193.5 milionë euro, ose pwr 26 milionë euro më të larta se vitin që po e lëmë. Përkundër synimeve tona që këto të hyra në të ardhmen të zvogëlohen dhe të zëvendësohen

nga të hyrat e TVSH-së brenda, ende vazhdojnë me një trend të lartë.

Të hyrat e TVSH-së vendore do të jenë 44.5 milionë euro, që në krahasim me vitin 2003 janë për 3.5 milion euro më të larta. Ky tregues është pozitiv, por ende është larg synimeve tona.

Tatimi në fitim do të jetë 34.1 mil-

ionë euro, apo për 15.4 milionw euro më i lartë se të hyrat e parashikuara nga ky pozicion në vitin 2003. Rritja e të hyrave nga ky tatim është edhe rezultat i orientimeve të komunitetit të biznesit që të kalojë nga tatimi i paragjykuar në tatimin në fitim. Si rezultat i tatimit të paragjykuar, pra do të kemi një ulje dhe parashihet të jetë 18.1 milionë euro apo do të jetë më i ulët për 8.9 milionë euro, krahasuar me vitin që po e lëmë. Tatimi në të ardhura personale do të ketë një rritje shumë të vogël, përkatësisht të hyrat nga ky tatim do të rriten nga 16 milionë sa ishin në vitin 2003 në 16.2 milionë, që parashihen pra të jenë për 0.2 milionë më të larta në vitin 2004.

Ndërkaq, të hyrat nga taksat do të jenë mëse të dyfishuara. Ato do të jenë 52.1 milionë euro, apo 27.2 milionë euro më të mëdha se në buxhetin e vitit 2003. Rritja e tillë justifikohet me aplikimin e parë që ne bëjmë të dy mallrave që përfshihen në akticiza, është fjala për aplikimin e tiketave në duhan dhe në alkool.

Rritje e të hyrave vetjake të komunave

Të hyrat vetjake të komunave, sipas parashikimeve do të kenë një rritje prej 22%. Ato do të rezultojnë në një masë më të zvogëluar të të hyrave vetjake sesa që ne dëshirojmë. Shuma do të jetë 34 milionë, pra rriten për 6.2 milionë euro krahasuar me vitin paraprak.

Këtë e theksojmë, sepse mundësitë që ofron tatimi mbi pronën janë shumë të mëdha dhe po të reflektohet njëjtë në të gjitha komunat, ku kemi shembuj shumë pozitiv, që po të aplikohet në të gjitha kuvendet komunale do të kishim të hyra shumë më të efektshme.

Grante nga donatorët për buxhetin e vitit 2004 nuk do të ketë. Andaj, për herë të parë buxheti i konsoliduar i Kosovës në tërësi do të financohet nga të hyrat vetjake. Buxheti i konsoliduar i Kosovës për vitin 2004 arrin shumën totale. Do të thoja se është buxheti i përgjithshëm, sepse buxheti i konsoliduar, e shpjegova që mungon. Kur dihet se ai është 619.3 milionë euro, atëherë del se krahasuar me buxhetin e vitit 2003 që ishte 514.8 milionë euro, paraqet një rritje prej 102.4 milionë euro, apo për 20.3% më i lartë.

Buxheti i institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes për vitin 2004 do të shënojë një rritje prej 41.4 milionë euro, përkatësisht kjo pjesë e buxhetit të përgjithshëm të Kosovës do të rritet nga 234.6 milionë euro sa është në vitin 2003, ndërsa për vitin 2004 parashihet që ky pozicion të jetë 276 milionë euro. Shprehur në përqindje është për 17.6% më i lartë.

Pjesa e buxhetit dedikuar për përgjegjësitë e rezervuara për vitin 2004 është paraprakë që të jetë 154.5 milionë euro, ose 16 milionë euro, apo 11.5% më i lartë se në vitin 2003. Kjo pjesë e buxhetit të përgjithshëm të Kosovës ka normë më të ulët të rritjes që është si rezultat i bartjes së disa kompetencave nga pjesa e rezervuar në institucionet vetëqeverisëse.

Pagat

Pjesa e buxhetit dedikuar për paga do të jetë 187.6 milionë euro dhe shënon një rritje për 39.3 milionë. Tani pagat marrin pjesë në strukturën e shpenzimeve të buxhetit me 30.4%, kundruall pjesëmarrjes prej 28.8% në këtë vit që po e lëmë pas.

Subvencionet

Pjesa e shpenzimeve buxhetore e dedikuar për subvencione dhe transfere do të shënojë një rritje prej 21.1 milionë euro, apo për 20.2% dhe arrin shumën e planifikuar për 125.7 milionë, kundruall 104.6 sa ishte në vitin 2003. Për vitin 2004 këto shpenzime do të marrin pjesë në strukturën e shpenzimeve buxhetore me 20.39% apo gati në njëjtin nivel të pjesëmarrjes relative të vitit 2003 që ishte 20.31%.

Buxheti për pushtetin lokal me një normë të shtimit prej 33.2% paraqet pjesën e buxhetit të përgjithshëm të Kosovës me dinamikën më të shpejtë të rritjes. Ky buxhet shënon një progres të dukshëm. Derisa në vitin 2003 ishte 141.7 milionë euro, për vitin 2004 parashihen të jenë 188.8 milionë euro, që është më i lartë për 47.1 milionë euro. Fryti i kësaj rritjeje, do të thoja, ka të bëjë kryesisht për sferat e bartura nga institucionet e nivelit të përgjithshëm tek arsimiti i ulët, i mesëm dhe tek shëndetësia primare, si dhe shërbimi i zjarrfikësve që bartet nga pushteti qendror në buxhete komunale.

Dinamika e këtij viti do të jetë më e ulët se dinamika që po e lëmë pas. Në prioritetet të Qeverisë është përmirësimi i infrastrukturës së rrugëve dhe kjo reflektohet në rritjen e buxhetit të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, e cila për vitin 2003 kishte buxhetin 22.8 milionë euro dhe parashihet që për këtë vit të ketë 28 milionë euro, apo për 5.2 milionë euro më shumë.

Kompletimi i aktiviteteve dhe zgjerimi i politikave të regjistrimit të biznesit rezulton në rritjen e buxhetit për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për 2 milionë euro, që është për 1.2 milionë më i madh se viti që po e lëmë pas.

Ministria për Ekonomi e Financa ka shënuar një zvogëlim të buxhetit të saj nga 16.47 milionë euro, sa ka qenë në vitin 2003, meqë për vitin

2004 parashihet të ketë 14.2 milionë euro, ose 2.3 milionë më pak.

Ministria e Ambientit dhe e Planifikimit Hapësinor nuk ka rritje të buxhetit dhe është në nivelin që ishte në vitin që po e lëmë pas, do të thotë do të ketë 3 milionë.

Rezervat për raste të jashtëzakonshme të buxhetit do të jenë më të mëdha se ato të vitit 2003, duke shënuar një rritje dhe do të jenë në një nivel prej 12 milionë euro.

Në strukturën e shpenzimeve buxhetore për vitin 2004 është marrë në konsideratë rritja e karakterit zhvillimor të buxhetit duke e ruajtur karakterin e lartë social të saj. Andaj, mund të them se është realizuar një përmirësim kualitativ i strukturës së shpenzimeve buxhetore.

Nëse vërejmë strukturën e shpenzimeve buxhetore të aprovuara, do të na bie në sy zvogëlimi i pjesës së buxhetit për mallra dhe shërbime për 8.9 milionë euro, kundër rritjes së buxhetit në pjesët tjera të strukturës së shpenzimeve. Për vitin 2004 në strukturën e shpenzimeve buxhetore për mallra dhe shërbime janë ndarë 144.3 milionë euro, kundruall 153.2 milionë që ishin aprovuar në vitin 2003. Tani kjo pjesë e shpenzimeve merr pjesë në strukturën e shpenzimeve të buxhetit me 23.41%, kundruall pjesëmarrjes prej 29.8% në vitin 2003. Edhe këtu kryesisht kemi të bëjmë me atë se administrata e pushtetit

[/ vijon në faqe 6 /](#)

qendror apo lokal gradualisht është në kompletimin e pajisjeve, ku kryesisht mallrat dhe shërbimet kanë shkuar për orendi dhe inventar tjetër që ishin në procesin e themelimit të tyre.

Avancim i veçantë është realizuar në pjesën e dedikuar për shpenzime kapitale, që ia rrit karakterin zhvillimor strukturës së buxhetit për vitin 2004. Pjesa e buxhetit të dedikuar për shpenzime kapitale në vitin 2004 do të jetë 123.5 milionë euro, që është për 54% më i lartë se ai që është aprovuar në vitin 2003, e cila ishte 80.2 milionë euro. Për

vitin 2004 është 24.9%, ose për 2 poena të indeksit më i ulët sesa ishte në këtë vit, pra në vitin 2003, që shprehur në përqindje ishte 26.9%.

Për të mos u lëshuar në komentetet e detajuara të buxhetit të fuqive të rezervuara, meqenëse në material janë dhënë në mënyrë majft të elaboruar, do të potencoj organizatat buxhetore të cilat më së shumti marrin pjesë në strukturën e buxhetit të fuqive të rezervuara dhe do t'i lexoj sipas kronologjisë. Këtë e bëj edhe nga një arsye, sepse në këtë buxhet operohet përmes nesh. Ne e moni-

Korniza duhet të ndryshojë drejt implementimit të statusit final të Kosovës

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese i Kuvendit të Kosovës, kryesuar nga dr. Arsim Bajrami organizoi një



Arsim Bajrami

dëgjim publik lidhur me nismën për ndryshimet në Kornizën Kushtetuese të Kosovës për të ofruar një ekspertizë profesionale për këto ndryshime. Baza juridike për këto ndryshime, u theksua me këtë rast, përmbahet në vetë Rezolutën 1244, e cila mëton qeverisjen substanciale të institucioneve të Kosovës drejt krijimit të kushteve për zgjidhjen e statusit final të saj. Korniza ishte bazë për themelimin e institucioneve të Kosovës e cila parasheh bartjen e përgjegjësiave hap pas hapi në institucionet e Kosovës, standardet e promovuara për Kosovën do të përmbushen shpejt dhe më mirë varësisht nga bartja e përgjegjësiave nga administrata ndërkombëtare në institucionet e Kosovës, si dhe ndërtimi i institucioneve të Kosovës në partneritet me UNMIK-un për të dalë nga rrethi vicioz i Rezolutës 1244. Pjesëmarrësit theksonin se Korniza nga vetë përmbajtja nuk mund të jetë e ngurtë e statike, ajo duhet të reformohet, sepse nga zhvillimi i proceseve që nga përfundimi i luftës, ajo në shumë pikëpamje është tejkaluar. Madje, këtë e kërkon vetë fakti që Kosova që nga aprovimi i saj ka mbetur në pikën zero sa i përket bartjes së kompetencave. Korniza duhet të ndryshojë drejt implementimit të statusit final të Kosovës. Nga disa pjesëmarrës u tha se ky akt juridik duhet të mbajë emrin Kushtetutë e Kosovës. Tashmë janë krijuar kushtet edhe për krijimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, asaj të Kasacionit, si dhe të Bankës Nacionale.

Në kuadër të këtij buxheti marrin pjesë këto agjenci shpenzuese:

Doganat 6.5 milionë euro;

Drejtorati i Çështjeve Administrative 5.2 milionë euro;

Zyra e Koordinatorit të TMK 15 milionë euro;

Shërbimet policore 52.9 milionë euro;

Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës 2 milionë euro;

Për Sektorin e Drejtësisë janë dedikuar 14.2 milionë euro;

Shërbimi i burgjeve 11 milionë euro;

Drejtorati i Çështjeve Rurale 1.16 milion euro;

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit 14.4 milionë euro; Struktura e shpenzimeve është e këtillë: pjesa më e madhe i dedikohet minierave të Trepçës me 7 milionë euro;

hekurudhat e UNMIK-ut me 2.5 milionë euro; Ngrohitorja qendrore me 1.3 milionë euro;

Mbeturinat dhe uji 1.4 milion euro; Aeroporti 1 milion euro; Shërbimet e administratës qendrore 0.6 milion euro dhe për administrimin dhe monitorimin e NPSH – Ndërmarrjeve shoqërore apo publike dedikohen 0.5 milion euro;

Njësia rregullative qendrore 4.1 milionë euro;

Minierat dhe mineralet 2.1 milionë euro;

Zyra rregullative e aviacionit civil 1 milion euro;

Radiotelevizioni i Kosovës 1 milion euro;

Zyra për Çështjet e Komuniteteve 1.6 milion euro; dhe

Zyra për kthimin e komuniteteve 10.5 milionë euro.

këtë shkak shpenzimet buxhetore të parapara për vitin 2004 rrisin pjesëmarrjen në strukturën e shpenzimeve buxhetore nga 15.6% , sa ishte aprovuar për vitin 2003 në 20.1% që do të jetë në vitin 2004. Buxheti i fuqive të rezervuara apo buxheti i rezervuar siç e quajmë ne, arrin shumën 154.5 milionë euro dhe paraqitet me 24.9% të buxhetit të përgjithshëm të Kosovës, që është për 16 milionë më i lartë se ai i vitit 2003. Ndërkaq, pjesëmarrja relative e buxhetit të fuqive të rezervuara në strukturën e tërësishme të buxhetit të përgjithshëm të Kosovës për

torojmë, por ne nuk e menaxhojmë.

Këtë e menaxhon PSSP.

Duke e ndier obligimin tim ligjor dhe qytetar për faktin se jam ministër i zgjedhur nga ky Parlament, kam synuar dhe përfundimisht ia kam arritur qëllimit që Kuvendit t'i ofroj një dokument nëpërmjet të cilit do të informohet dhe do t'i mundësohet debatimi, duke dhënë përkrahjen, por edhe duke bërë vërejtjet dhe sygjerimet dhe komentet e vlefshme që do të jenë në funksion të kualitetit buxhetor dhe në funksion të realizimit të prioritetëve të Qeverisë në kushtet ekzistuese mjaft të limituara.

Përvojë e mirë në funksionimin e pushtetit legjislativ, ekzekutiv e përfaqësues

Në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të 22 janarit, pikë e parë e rendit të ditës ishte fjala e presidentit të Kosovës Ibrahim Rugova. Duke marrë fjalën para deputetëve presidenti Rugova theksoi: Ndihej shumë i nderuar që kam mundësi të bëj këtë fjalim vjetor para Kuvendit të Kosovës, këtij institucioni të lartë të vendit tonë.

Në fillim, dëshiroj t'ju njoftoj se kam vendosur që fjalimi vjetor i presidentit të Kosovës të mbahet çdo vit në formë tradicionale - të enjten e parafundit të janarit.

Fjalimi i presidentit do të bëhet në formë solemne, në frymë të vlerësimit të gjendjes dhe të vizionit për kombin në fillim të vitit. Në këto katër vjet e gjysmë në liri, Kosova ka pasur një progres të madh në të gjitha fushat

e jetës. Mund të themi se këto ishin vite të forcimit të lirisë, të sigurisë, të ekonomisë dhe të demokracisë.

Periudhë e konsolidimit të institucioneve nacionale të Kosovës

Ndërsa sot, pas afër dy vjetësh të ndërtimit të institucioneve shtetërore të Kosovës, do të them se këto institucione kanë funksionuar me sukses. Kjo ishte një periudhë e konsolidimit të institucioneve nacionale të Kosovës.

Me këtë rast, do të veçoja punën e Kuvendit të Kosovës, i cili ka miratuar me dhjetëra ligje sistimore, apo bazike dhe ligje të tjera, si dhe rezoluta e deklarata të ndryshme në interes të qytetarëve të vendit tonë.

Mendoj se gjatë kësaj kohe, Kuvendi i Kosovës ka kultivuar frymën dhe funksionimin demokratik të institucionit. Po ashtu, edhe Qeveria - me të gjitha ministrinë ka funksionuar



Presidenti Rugova duke mbajtur fjalën para deputetëve të Kuvendit të Kosovës

mirë dhe ka arritur të jetë një ekzekutiv i qëndrueshëm.

Presidenti i Kosovës është kujdesur për funksionimin e institucioneve dhe i ka ndihmuar ato me ide e propozime dhe ka luajtur rolin reprezentativ të popullit dhe të qytetarëve në vend dhe jashtë. Prioritet kryesor ka qenë ruajtja dhe forcimi i stabilitetit politik dhe shtetëror të vendit.

Mund të themi se kemi fituar një përvojë të mirë në funksionimin e pushtetit legjislativ, ekzekutiv e reprezentativ, si dhe të vendosjes së shtetit ligjor.

Do përmendim këtu edhe funksionimin e mirë të pushtetit lokal të vendit që - gjithnjë e më shumë po forcohet, e që ka gëzuar përkrahjen tonë.

Në planin ekonomik, Kosova ka pasur progres. Është forcuar sektori privat në të gjitha fushat, që sot përbën gjysmën e ekonomisë. Gjatë

kësaj kohe, kosovarët kanë treguar shpirtin e tyre ndërmarrës dhe dinamik.

Element me rëndësi është edhe buxheti i Kosovës, që mblihet nga të ardhurat vetanake - çfarë tregon se Kosova është në gjendje të funksionojë si shtet.

Në masë të madhe është përmirësuar infrastruktura e përgjithshme dhe infrastruktura rrugore - nacionale e lokale - ku do të realizohen projekte

të rëndësishme - si pjesa kosovare e autostradës Prishtinë-Durrës që ka edhe karakter ndërkombëtar.

Edhe trafiku ajror i Kosovës ka pasur sukses nga kompanitë e ndryshme, e sidomos me themelimin e Kompanisë Ajrore Kosovare dhe me modernizimin e Aeroportit të Prishtinës, dhe së shpejti të Aeroportit të Gjakovës.

Në fushën e telekomunikacimit, ka pasur progres në telefoninë mobile e fikse dhe tash po hyjmë në fazën e konkurrencës. Po ashtu do të forcohet sistemi i internetit për të gjithë qytetarët.

Gjatë kësaj kohe, është forcuar siguria publike. Policia e Kosovës sot ka një kontingjent të qëndrueshëm që duhet të specializohet për detyra të ndryshme.

Trupat Mbrojtëse të Kosovës kanë arritur fazën e organizimit dhe do të kenë përkrahjen tonë në konsolidimin dhe profesionalizimin e tyre

- që të jenë forcë e aftësuar për detyrat e veta dhe forcë mbrojtëse në të ardhmen.

Në fushën e arsimit po realizohet procesi i reformave. Që të kemi një arsim kompatibil në zhvillimet ekonomike dhe demokratike të vendit do të angazhohemi për një kompjutorizim të shkollave që çdo fëmijë të ketë qasje dhe të mësojë gjuhën angleze, që po bëhet gjuhë e dytë në Kosovë.

Shëndetësia gjendet në etapën e reformimit dhe do të ndihmojmë që kjo fushë e rëndësishme të stimulohet dhe do të bëjmë përpjekje për vendosjen e mjeksësisë së lartë. Çështjet sociale kanë qenë prokupim për kujdesin ndaj grupeve të caktuara sociale, për punësimin e tyre dhe për ndihma. Ne duhet të shikojmë mundësitë e konsolidimit të fondit të pensioneve, të invalidëve të punës dhe të luftës.

Spektori i bujqësisë ka pasur përpajime dhe do të angazhohemi për stimulimin dhe subvencionimin e projekteve në këtë degë, siç veprohet në Bashkimin Evropian dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe në vende të tjera. Kosova ka një tokë fertile, që është në gjendje ta ushqejë popullin e vet.

Në fushën e mbrojtjes së ambientit ka pasur kujdes të shtuar dhe duhet të bëjmë përpjekje për hartimin e planeve hapësinore nga komunat dhe për të gjitha qytetet e vendbanimet në harmoni me planin global hapësinor të vendit tonë, që është në përgatitje e sipër.

Në fushën e kulturës kemi pasur përpajime të qëndrueshme dhe do të bëjmë më shumë për financimin e këtij segmenti me vlerë të vendit tonë dhe të afirmimit të këtyre vlerave kosovare në botë.

Viti, në të cilin kemi hyrë, do të jetë vit i progresit më të madh të Kosovës në të gjitha fushat, sepse kemi krijuar një bazë të mirë të zhvillimit.

Ne do t'i kushtojmë më shumë vëmendje zgjidhjes së problemit energjetik, që është element kyç për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Në planin e brendshëm ne do të vazhdojmë të punojmë në integrimin e grupeve etnike apo minoriteteve në shoqërinë dhe në shtetin e Kosovës dhe në garantimin e mbrojtjes së tyre. Njëherësh dëshirojmë një vullnet më të madh të minoriteteve për integrim në shoqërinë dhe në shtetin e Kosovës.

Një kujdes të veçantë do të kemi për mundësinë e përfaqësimit të Kosovës përmes hapjes së zyrave në botën e jashtme apo formave të tjera. Në vitin 2002 kemi bërë një hap në këtë plan me emërimin e mikut të madh të Kosovës - senatorit Dol ambasador nderi të Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo është një çështje vitale për Kosovën në këtë fazë të zhvillimit. Ne do të kërkojmë një liberalizim të vizave, sidomos për njerëzit e biznesit të Kosovës me vendet e Bashkimit Evropian dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Një veprim të përbashkët do ta bëjmë me UNMIK-un rreth bartjes së kompetencave me qëllim të shtimit të efikasitetit të institucioneve të Kosovës. Ky është një proces që duhet ta zhvillojmë së bashku.

Një element tjetër me rëndësi do të jetë puna në vlerësimin e standardeve të paraqitura, të atyre që i kemi përmbushur dhe të atyre që do t'i përmbushim në bashkëpunim me UNMIK-un, OSBE-në dhe me KFOR-in.

Angazhim për ndriçimin e fatit të të zhdukurve

Njëherit do të punojmë dhe insistojmë në njohjen formale të pavarësisë së Kosovës - e cila gjë do të shpejtonte e stabilizonte proceset e brendshme ekonomike e demokratike dhe do të qetësonte këtë pjesë të Evropës, të botës dhe popullin e Kosovës - pra një Kosovë e pavarur, demokratike e paqësore - e integruar në Bashkimin Evropian, në NATO dhe në miqësi permanente me Shtetet e Bashkuara të Amerikës që është vullnet politik i popullit dhe i qytetarëve.

Vëmendje të veçantë do t'i kushto-

jmë kultivimit të marrëdhënieve të mira me fqinjët e vendit tonë dhe t'i përparojmë ato çfarë është politikë nacionale e Kosovës.

Në vjeshtë na presin zgjedhjet e dyta nacionale të Kosovës së lirë. Ne jemi të bindur se do të kemi zgjedhje të mira e të qeta, sepse tash kemi një eksperiencë të mirë në këtë plan. Të gjithë duhet të kontribuojmë në këtë drejtim. Kosova e ka dhënë tashmë këtë provim. Do thënë se Kosova po hyn në fazën e një vendi normal dhe është e gatshme t'i pranojë obligimet ndërkombëtare.

Do t'i shikojmë të gjitha mundësitë e angazhimit tonë në ndriçimin e fatit të të zhdukurve. Njëherish sot i kujtojmë me pietet të lartë të gjithë ata që rënë për lirinë, pavarësinë dhe demokracinë e vendit tonë.

Me këtë rast përshëndesim zotin Hari Hollleri e UNMIK-un, ambasador Fieskin e OSBE-në, si dhe gjeneralin Kamerhof e NATO-n dhe KFOR-in që po bëjnë një punë ekselente në mbrojtjen dhe sigurinë e Kosovës. Po ashtu përshëndesim Korin diplomatik në kryeqytetin e Kosovës në Prishtinë. Njëherit përshëndesim institucionet ndërkombëtare financiare në Prishtinë dhe donatorët që po e ndihmojnë Kosovën.

Nga kjo seancë solemne e Kuvendit të Kosovës përshëndesim presidentin Bush, kryeministrin Bler, presidentin Shirak, kancelarin Shroder dhe kryeministrin Berlusconi, të cilët vazhdimisht e përkrahin Kosovën.

Përshëndetje të veçantë i bëjmë atit të shenjt papa Gjon Palit të dytë që gjithmë lutet për Kosovën.

I nderuar kryetar Daci, në fund të këtij fjalimi, dëshiroj t'ju njoftoj se së shpejti do të fillojmë ndërtimin e pallatit presidencial - shtëpisë së bardhë të Kosovës dhe do t'ju ftoj së bashku me deputetët e nderuar në këtë ceremoni solemne e të rëndësishme për vendin tonë.

Zoti ju bekoftë! Zoti e bekoftë Kuvendin e Kosovës! Zoti e bekoftë Kosovën, uroi kryetari i Kosovës, dr Ibrahim Rugova.

Përkushtim më i madh për përmbushjen e standardeve

Çfarë mund të presin qytetarët e Kosovës nga organi më i lartë ligjvënës deri në fund të këtij mandati në fushën e shqyrtimit dhe miratimit të ligjeve, si dhe në inicimin dhe shtruarjen e çështjeve tjera me interes jetik për qytetarët e Kosovës ?

FATMIR SEJDIU, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës:

Të miratojmë sa më shumë ligje bazike në mënyrë sistemore, si dhe ligje nga fushat deri tani të rezervuara

Besoj që faza që do të vijë do të përshkohet me një aktivitet edhe më të ngjeshur të Kuvendit të Kosovës, në veçanti në miratimin e më shumë ligjeve . Interes yni i drejtpërdrejt është që të miratojmë sa më shumë ligje bazike në mënyrë sistemore dhe në veçanti edhe ligje nga fushat deri tani të rezervuara, që do të jenë përgjegjësi e institucioneve të Kosovës. Po kështu mendoj se Kuvendi do të miratojë ndryshime për Kornizën Kushtetuse të cilat do të jenë bazë e rëndësishme për zhvillimin e proceseve të mëtejme dhe në punën e institucioneve të Kosovës . Mendoj që në veçanti duhet përkushtuar kujdes përmbushjes së standardeve nga ana e



institucioneve si faktor kyç për të hyrë në procesin e definimit të statusit final të Kosovës, i cili duhet të jetë në pajtim me vullnetin e popullit të Kosovës, pra njohja e Pavarsisë së Kosovës .

OLIVER IVANOVIQ, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës:

Kthimi në pronësi të pasurisë së uzurpuar serbëve dhe Kishës ortodokse serbe

- Qytetarët mund të presin miratimin e ligjeve të domosdoshme, para së gjithash, të atyre ligjeve që janë në procedurë të Kuvendit, si dhe të atyre që në bazë të amendamenteve të koalicionit "Kthimi" dhe të grupeve tjera parlamentare në Kuvend janë kthyer në përpunim. Disa Propozim-ligje kanë kaluar panelin e shqyrtimit, për disa janë përkrahur propozimet për panel, prandaj pres përmirësim kualitativ të akteve të propozuara ligjore, si dhe propozimin e akteve të reja në lëmitë që deri më tani nuk janë bërë.

Koalicioni "Kthimi", edhe pse këtë disa herë deri më tani e ka bërë, përsëri do ta iniciojë shqyrtimin për çështjet me rëndësi për bashkësinë serbe në Kosovë. Ato janë para së gjithash kthimi i serbëve dhe joshqiptarëve që edhe pas katër vite e gjysmë nuk janë kthyer në pronësinë e uzurpuar. Pastaj, kthimi në pronësi të pasurisë serbëve dhe



Kishës ortodokse serbe, çështja e privatizimit, situata energjetike dhe gjendja në elektroekonomi, si dhe diskutimi për afarizmin e ndërmarrjeve të mëdha publike dhe gjendja e tyre.

Pres se kjo do të merret parasysh, për shkak se gjendja në lëmitë e theksuara dukshëm do të ndikojë në vlerësimin për realizimin e standardeve për Kosovën.

PËRPJËKJE TË PAR-RESHTURA PËR TË RRITUR RITMIN E PUNËS DHE CILËSINË

Sa jeni të kënaqur me prezentimin e Skërkesave dhe synimeve të zgjedhësve tuaj gjatë këtij mandati në Parlamentin e Kosovës. A mund të thuhet se Parlamenti i Kosovës po sendërton besimin e dhënë nga ana e qytetarëve ?

SABRI HAMITI, shef i Grupit parlamentar të LDK-së:

Të zgjedhurit në Kuvend janë ndodhur shpesh në situata të rënda

Çdo njeri i zgjedhur në institucionin më të lartë përfaqësues e politik, siç është Kuvendi i Kosovës, merr obligim që të shtrojë kërkesat e qytetarëve dhe të kërkojë zgjidhje për to. Ne jemi përpjekur që kërkesat e qytetarëve, ato themelore jetësore dhe ato fundamentale që lidhen me Kosovën, t'i trajtojmë në Kuvendin e Kosovës . Kemi qenë edhe më të vëmendshëm e të përgjegjshëm duke

/ vijon në faqe 10 /

ditur që krijojmë një shumicë në Kuvend, pa të cilën vështirë mund të mirren vendime.

Mendoj që Kuvendi i Kosovës ka bërë



shumë për miratimin e ligjeve të reja, duke u përpjekur që ta rrisë ritmin e punës dhe cilësinë. Po kështu Kuvendi me një pjekuri, në formë të deklaratave e të rezolutave, ka përdënuar qëndrimin e vet për çështjet më të ndieshme politike, ekonomike e sociale të Kosovës.

Por, të zgjedhurit në Kuvend janë ndodhur shpesh në situata të rënda ndërmjet vullnetit e detyrës për të mbrojtur interesat e qytetarëve të Kosovës dhe pengesave e ndërhyrjeve procedurale të administratës së huaj në Kosovë.

Punojmë e shpresojmë që raportet me administratën ndërkombëtare do të ndryshojnë.

BERAT LUZHA, *zëvendëskryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së:*

Nuk janë vetëm kompetencat që na pengojnë

- Grupi ynë kuvendor ka bërë përpjekje që t'i prezantojë në Kuvend të gjitha preokupimet e qytetarëve, varësisht nga agjendat që janë krijuar për mbledhjet e Kuvendit. Ne i kemi propozuar Kryesisë së Kuvendit një varg të gjatë temash me rëndësi për Kosovën, por shumica prej tyre, për shkaqe të panjohura për ne, ende nuk janë futur në rendin e ditës. Më konkretisht, Grupi ka qenë gjatë tërë kohës promotor i punës në Kuvend, duke kërkuar azhuritet më të madh, duke qenë gjithnjë në nivelin e detyrave, duke i shtjelluar problemet qenësore me seriozitetin e duhur, duke u përpjekur për avancimin e punës së Kuvendit dhe përmes tij, edhe të statusit politik të Kosovës.

Kuvendi i Kosovës mundet dhe

duhet të jetë pak më ndryshe nga që është tash. Në çështjet me rëndësi vitale, ai duhet të jetë i një mendjeje dhe i një goje. Duhet të jetë shumë më azhur

në punën e vet, duke mbajtur mbledhje më të gjata, më të shpeshta e më të ngjeshura.

Natyrisht, ne jemi të vetëdijshëm për kufizimet që ka nga administrata e UNMIK-ut dhe për shumë probleme të tjera, por nuk mund të kuptohet kur ai shpesh e pengon vetveten. Kuvendit i bie barra të ballafaqohet me të gjitha problemet kryesore të Kosovës, por që të ketë sukses në këtë drejtim, duhet të jetë më i organizuar, më transparent dhe më i vendosur. Në këtë mënyrë do ta fitonte edhe besimin e qytetarëve, të cilët presin shumë më tepër nga ai.

Të gjithë ne e dimë se çfarë zhgënjimi po ndodh te qytetarët, te votuesit, te populli i Kosovës. Dhe, duhet ta përsëris, nuk janë vetëm kompetencat që na pengojnë. Do të duhej të ishte koha e fundit që të punojmë shumë seriozisht dhe të mos tallemi kështu me qytetarët, duke i shqiptuar atij sllogane pompoze, por të pambulesë. Me këtë rast vlen thënia e popullit: T'i shtrijmë këmbët sa e kemi jorganin, por gjithnjë duke punuar për ta rritur jorganin tonë.

Në këtë aspekt, mendoj se Kuvendi i Kosovës ende nuk është ai, të cilin qytetarët do ta kishin dëshiruar, të cilit do t'ia kishin dhënë besimin e plotë.

DRAGISHA KËRSTOVIQ, *shëf i grupit parlamentar "Kthimi"*

Shpeshherë kishte në rend dite edhe çështje politike që buronin nga interesa partiake

- Nuk jam i kënaqur me prezentimin e kërkesës së zgjedhësve që i përfaqëson koalicioni "Kthimi" gjatë këtij mandati të koalicionit. Në të vërtetë, shpeshherë



në rendin e ditës ka patur çështje që nuk ishin interes i zgjedhësve, por kryesisht interes politik i disa partive politike. Grupi parlamentar



"Kthimi" vetëm njëherë ia ka arritur që, në rendin e ditës, ta vendos çështjen për të cilën sidomos ka qenë i interesuar e kjo ishte çështja e kthimit të të zhvendosurve, por prezentimi i kësaj çështjeje është bërë me një epilog dhe mënyrë të jashtëzakonshme që nuk i ka përmbushur dëshirat e këtij koalicioni. Fat të ngjashëm përjetuan edhe shumë amendamente të koalicionit "Kthimi" të paraqitura në ligje që ishin në procedurë. Tani për tani, Parlamenti i Kosovës nuk e përmbush besimin e fituar nga qytetarët në zgjedhje.

BUJAR DUGOLLI, shëf i Grupit parlamentar të AAK-së:

Elektorati ynë është i kënaqur me punën që e kemi bërë

- Duke marrë për bazë që kjo ka qenë për ne një përvojë e parë e punës në Parlament, sepse grupi ynë parlamentar ka deputet që nuk



kanë qenë ndonjëherë në parlamente demokratike, apo të zgjedhura drejtpërdrejt nga populli, siç është ky, mendoj që ne kemi arritur që në këtë mandat t'i paraqesim ato kërkesa të elektoratit tonë që na ka zgjedhur në Kuvendin e Kosovës dhe një pjesë të tyre t'i realizojmë me sukses, falë një politike të bashkëpunimit që e kemi ndjekur si grup me dy grupe tjera më të mëdha politike në vend, siç është grupi LDK -së dhe ai i PDK-së, por edhe i minoriteteve të tjera dhe normalisht të gjitha ato kërkesa që i kemi pasur si grup

parlamentar nuk i kemi realizuar, por kjo është një formë e tillë: diçka kalon e diçka nuk kalon, sido që të jetë mendojmë se e kemi paraqitur interesin e elektoratit tonë si parti politike, ndaj strukturat politike të partisë dhe eloktarati ynë është i kënaqur me punën që e kemi bërë. Normalisht ne nuk kemi mundur të bëjmë më shumë, sepse fuqia jona elektorale e Kuvendit ka qenë e tillë që shumë gjëra nuk kemi mundur t' i shtyjme, por përpjekjet i kemi bërë dhe ato nuk janë pa sukses. Sa i përket asaj se a mund të themi se Parlamentit e sendërton besimin edhe nga ana e qytetarëve mendoj që ka arsye, si të them për një brengosje, apo vërejtje që e bëjnë qytetarët ndaj Parlamentit të Kosovës dhe në përgjithësi ndaj institucioneve, sepse ne nuk kemi arritur në këtë mandat ta rikonfirmojmë vullnetin tonë për statusin politik, nuk kemi arritur që të ballafaqohemi apo të kërkojmë të gjitha kompetencat, transferin e tyre në mënyrë të shpejtë dhe kjo nuk ka ndodhur, ndaj si rezultat i saj qytetarët janë në një masë të zhgënjyer nga institucionet e Kosovës, por thjesht them se ka pasur mundësi të punohet më shumë po të ishin të vendosur, domethënë edhe grupet më të mdha politike, në këtë rast grupi i LDK-së, sepse ka shumicën në Kuvend. Mendoj se ai që e ka shumicën e mban edhe shumicën e fajit dhe përgjegjësinë për mospunjen e Kuvendit dhe të institucioneve të Kosovës. Sido që të jetë ne nuk kemi heshtur në mospunje, vazhdimisht kemi reaguar dhe kemi kritikuar. Kemi kërkuar një dinamizëm më të madh, kemi kërkuar një punë më të sukseshme, po normalisht kemi kërkuar një bashkëpunim edhe më të madh, kështu që po të ishte një gjendje ndryshe p.sh. në Parlament një strukturë e përfaqësimit ndryshe në grupin parlamentar kjo do të reflektohej në mënyrë më të sukseshme.

GANI SADIK, kryetar i grupit "Të tjerët"

Rrethanat e reja kërkojnë ligje moderne e demokratike

Parlamenti i Kosovës, në përbërjen e tij të re dhe në rrethana të reja, ka nevojë të madhe për ligje moderne e demokratike. Anëtarët e Parlamentit të Kosovës, si në fillim edhe tani, rregullisht dhe në mënyrë intenzive angazhohen në drejtim të prurjes dhe miratimit të këtyre ligjeve. Statusi i padefinuar i gjuhës turke është problem i përgjithshëm i tyre në Kosovë. Duke pritur mirëkuptim, vazhdojnë angazhimet tona në këtë drejtim.



Tre deputetët e përkatësisë turke në Parlamentin e Kosovës, procesverbalet nga mbledhja e Kuvendit dhe komisioneve i marrin në gjuhën e vet amtare dhe këtë sinçerisht duhet përshtetur. Mirëpo, në lëmin e arsimit ekziston problemi i librave. Në shkollat, nga radhët tona, rrallëherë apo fare nuk kemi zëvendës drejtorë.

Situata është ajo që më së tepërmi i brengos turqit në disa komuna, sidomos në atë të Prishtinës. P.sh. Emrat dhe mbiemrat në letërnjoftimet e turqve nuk shkruhen në pajtim me rregullat e drejtshkrimit të kësaj gjuhe. Certifikatat e lindjes, vdekjes dhe të kurorës nuk shkruhen në këtë gjuhë. Në komunën e Prishtinës vula dhe të dhënat në tabelën e shpalljeve nuk shkruhen edhe në gjuhën turke. Nëse i japim një vështrim komunave ku jetojnë turqit, në disa prej tyre përdoret gjuha turke e në disa fare nuk ekziston. Këtë laramani duhet mënjanuar.

Shikuar në përgjithësi, në aspektin e sigurisë nuk kemi probleme. Ne dëshirojmë që kjo siguri të zgjasë, në mënyrë që të jetojmë në rrethana sa më përshtatshme.

Turqit e Kosovës i besojnë Parlamentit të Kosovës dhe se me shumë shpresë shikojnë në ardhmëri.

Parlamenti i Kosovës meriton vlerësim pozitiv nga të gjithë ne.

KOMISIONI PARLAMENTAR KA PRITUR FAMILJARËT E PERSONAVE TË ZHDUKUR SERBË NGA KOSOVA

Qasje humanitare për zbardhjen e fatit të të pagjeturve dhe të të kidnapuarve

Problemit të personave të pagjetur dhe të kidnapuar duhet t' i qasemi nga aspekti humanitar në mënyrë të paanshme dhe pa dallim kombësie. Për zgjidhjen e këtij problemi është e nevojshme një punë edhe më e ngulmët, sidomos duke ndërtuar institucione të mirëfillta që do të punonin me kompetencë të plotë në zbardhjen e fatit të të pagjeturve. Gjithë ky aksion duhet të mbështetet në Konventën Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq, sipas së cilës secili qytetar ka të drejtë të interesohet për fatin e anëtarëve të familjes së tij. Këto ishin disa nga konstatimet thelbësore të takimit me familjarët e personave të pagjetur dhe të kidnapuar serbë të Kosovës me Komisionin Parlamentar të Kuvendit të Kosovës për persona të kidnapuar dhe të pagjetur, i cili u mbajt nën drejtimin e Flora Brovinës, kryetare e këtij komisioni. Me këto mesazhe duhet të senzibilizohet opinioni i Rajonit, por edhe ai ndërkombëtar, për të bërë presion te strukturat përkatëse të vendosjes për një angazhim edhe më të madh për zbardhjen e fatit të të zhdukurve. Kjo duhet të jetë edhe temë prioritare gjatë bisedave ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në këtë frymë u propozua të bëhet një apel edhe në KS të OKB-së që të lirohen të gjithë të kidnapuarit e gjallë. Takimi u shoqërua me shumë emocione, në fillim edhe me përpjekje për politizime, por duke u thelluar në tërë këtë problem aq të rëndë e kompleks, diskutimet u orientuan në hulumtimin e rrugëve të përbashkëta për zgjidhjen e tij. Në këtë takim u shtrua edhe kërkesa që të gjenden edhe përgjegjësit e varrezave masive në Batajnicë e gjetiu, në mënyrë që bartësit e krimeve të marrin dënimin e merituar.

U përurua salla e K



Më 16 shkurt të këtij viti u përurua salla e renovuar e Kuvendit të Kosovës. Enterieri i ri i Kuvendit të Kosovës përfshin sallën, hollin dhe hyrjen e ndërtesës së Kuvendit të Kosovës, punë këto të kryera nga punonjësit e firmës "Mabetex Group", të cilët këtë punë e filluan në korrik të vitit që shkoi. Renovimi i enterierit të ndërtesës së Kuvendit të Kosovës, pos tjerash ka përfshirë instalimet elektronike që kanë të bëjnë edhe me numrimin e votave, zërimin, klimatizimin, si dhe sistemin e nxemjes etj. Jane krijuar kushte optimale për punë për të gjitha organet e Kuvendit të Kosovës.

Pos ambientit me një imazh e komoditet më të mirë, deputetët dhe punonjësit e Kuvendit të Kosovës kanë në dispozicion një hapësirë shumë më funksionale se deri më tash, në të gjitha segmentet e punës. Vështruar nga ana teknike, gjithë kjo do t'iu mundësojë deputetëve veprimtari sipas standardeve të parlamenteve evropiane e botërore. Përirimin e sallës në një petk të ri e bënë kryetari i Kuvendit, Nexhat Daci dhe kryetari i Kosovës, Ibrahim Rugova. Kryeparlamentari Nexhat Daci duke e prerë shiritin së bashku me kryetarin e Kosovës Ibrahim Rugova, tha se



Kryetari i Kosovës, dr. Ibrahim Rugova dhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, prof. Nexhat Daci duke prerë shiritin e sallës së renovuar të Kuvendit të Kosovës

Kuvendit të Kosovës

inaugurimi i kësaj salle përbën një ndjenjë të veçantë, si dëshimi se institucioneve të Kosovës po u krijohet një hapësirë pune që i ngjan vërtet Evropës dhe mbarë botës demokratike. Në këtë çast solemn kryetari i Kosovës, dr Ibrahim Rugova tha :'' Kjo është edhe një shenjë e progresit në Kosovë. Përrurimi solemn i sallës së Kuvendit është ngjarje me rëndësi që tregon se institucionet e Kosovës janë të vendosura të krijojnë objekte shtetërore të përshatshme për punë, të cilat do të jenë simbol i vendit tonë dhe i pavarësisë''. Kryetari Rugova me këtë rast propozoi që të shikohet mundësia për renovimin komplet të ndërtesës së Kuvendit për të krijuar kushte edhe më të mira pune , si dhe të ndërmerren hapa të tjerë për ndërtimin e ndërtesave të kryeministrit dhe të ministrive . Në përrurimin e sallës së Kuvendit të Kosovës nuk mori pjesë shefi i UNMIK-ut, Harri Holkeri ,për shkak të vendosjes së disa pikturave murale në hollin e Kuvendit të Kosovës, të cilat sipas kryeadministratorit u karakterizuan si monoetnike . Mbledhja e parë e Kuvendit të Kosovës në ambient të ri ishte caktuar të mbahej më 18 shkurt, por kjo atë ditë nuk arriti të mbahej për shkak të disa mosmarrëveshjeve rreth ulëseve të deputetëve . Mbledhja e Kuvendit filloi të nesërmen , më 19 shkurt.



Një pamje nga seanca e parë në sallën e renovuar të Kuvendit të Kosovës



Holli i Kuvendi të Kosovës

Interes i ndërsjellë për bashkëpunimin Kosovë-Shqipëri dhe për integrimet kombëtare e ndërkombëtare

Argumentet për Kosovën të prezantohen edhe nga institucionet dhe përfaqësuesit diplomatikë të Shqipërisë UNMIK-u ta përmbush misionin e tij në Kosovë dhe stafi më i mirë i tij të shndërrohet në këshilldhënës të institucioneve të mëvetësishme të Kosovës

Pikëpamje shumë të ngjashme për zhvillimet në Kosovë, në Shqipëri dhe në rajon, si dhe për integrimet gjithëpërfësirëse kombëtare e euroatlantike të të dyja vendeve u shpërfaqën në takimin e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, me kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, Fatos Nano.

Në interesimet e kryeministrit Nano për të ditur më shumë për raportet e udhëheqjes së vendit me administratën ndërkombëtare në Kosovë dhe për zgjidhjen e problemit të Mitrovicës, kryeparlamentari Daci është shprehur se marrëdhëniet e partneritetit me UNMIK-un duhet të ndryshojnë, duke u përmbushur misioni fillestar i tij, për të mbetur në fund një staf i vogël këshilldhënësish profesionistë. Problemi i Mitrovicës, ndërkaq është shprehur Daci, do të zgjidhet kur qytetarët serbë të Kosovës ta njohin statusin dhe tërësinë e Kosovës. Pastaj, është shprehur profesor Daci, mund të gjenden zgjidhje të pranueshme edhe nëpërmjet të procesit të decentralizimit.

Duke folur për procesin e implementimit të standardeve për Kosovën dhe ndihmën që shteti shqiptar mund t'i japë këtij procesi, Daci është shprehur se argumentet për Kosovën dhe vullnetin e popullit të saj të prezantohen gjithandej nga institucionet dhe diplomacia e shtetit shqiptar. Kryeministri shqiptar, Fatos Nano, është angazhur që të nxiten dhe të promovohen, jo vetëm



Takimi Daci-Nano

shkëmbime edhe më intensive të institucioneve të të dy vendeve, por edhe inicativa për aleatë të përbashkët. Kohën deri në vitin 2005, kur pritet të fillojë zgjidhja e statusit të Kosovës, Nano e ka quajtur kohë të mjaftueshme për shpërfaqjen e aftësive të klasës politike në Kosovë dhe në Shqipëri. Ai ka folur me besim për kufij të hapur për qytetarë, mallëra dhe ide. Të mbyllur do të jenë vetëm për keqbërësit, ka shtuar kreu i Qeverisë shqiptare. Pas takimit kryeministri Nano dhe shoqëruesit e shumtë nga Kuvendi, Qeveria dhe mediat shqiptare kanë vizituar Sallën e seancave plenare dhe pjesët tjera të renovuara të Kuvendit të Kosovës.

Projekte konkrete për mbështetje të Kuvendit të Kosovës

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, ka pritur sot një delegacion të parlamenteve nga Belgjika, Franca dhe Gjermania, në përbërje: Robert Myttenare, sekretar i përgjithshëm në Parlamentin Belg, Carinne Luquiens, drejtoreshë për marrëdhënie ndërkombëtare në Asambleenë Nacionale Franceze dhe Evahard Voss, drejtor për marrëdhënie ndërkombëtare në Bundestagun Gjerman. Në takim është biseduar për mundësitë e bashkëpunimit me këto parlamente, të cilat kanë projekte të përbashkëta për mbështetjen e Kuvendit të Kosovës. Profesor Daci ka folur për punën që bën Kuvendi i Kosovës për miratimin e ligjeve, kompatible me legjislacionin e vendeve të Evropës perëndimore, për zhvillimet demokratike të vendit dhe barazinë e të gjithë qytetarëve të Kosovës, pavarësisht nga përkatësia etnike dhe fetare e tyre. Ai është shprehur se në funksion të mbarëvajtjes së legjislativit po punohet për fuqizimin profesional të komisioneve parlamentare dhe pavarësimin e Kuvendit nga ekzekutivi, si në planin administrativ, shtu edhe në atë financiar. Numri një i Kuvendit të Kosovës, ndërkaq, duke folur për përbërjen e Kuvendi ka theksuar faktin se shqiptarët me 90 për qind të popullsisë së

Kosovës, janë përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës nga shtatë subjekte politike, me sa janë përfaqësuar edhe bashkësitë tjera etnike. Daci ka thënë me këtë rast se grupet e ndryshme etnike dhe politike në Kosovë duhet të përfaqësohen në raport me fuqinë reale të tyre dhe të mos eksperimentohet më në atë mënyrë që një grupacion me pesë përqind të votave të përfaqësohet me 20 për qind ulseve në Parlament. Në takim Daci ka shtruar nevojën sublimimit të përvojave parlamentare perëndimore dhe inkuadrimit në mekanizmat Evropian, duke shtuar se Kosova do të bashkëpunojë me të gjitha vendet dhe se vendi i saj do të jetë në Evropën e Bashkuar. Përfaqësuesit e parlamenteve të Belgjikës, të Francës dhe të Gjermanisë kanë shkoqitur projektet konkrete të cilat i kanë zhvilluar për Kuvendin e Kosovës dhe kanë kërkuar të dijnë se si do ta ndihmonin më së miri Kosovën dhe parlamentin e saj. Në këtë vështrim kryeparlamentari Daci ka kërkuar këmbim të ndërsjellë të përvojave, kurse sa u përket informatave nga Kosova është shprehur se ato duhet të sigurohen nga dorë e parë. Ai është shprehur i prerë se përfaqësuesve legjitim të Kosovës duhet tu mundësohet prezantimi i së vërtetës për Kosovën para mekanizmave autoritarivë ndërkombëtarë.

Një delegacion i minatorëve të "Trepçës" vizitoi Kuvendin e Kosovës

Duke përkujtuar se greva e minatorëve të "Trepçës" është një ngjarje e madhe me një vlerë të pazëvendësueshme, prof. dr. Fatmir Sejdiu theksoi se ekziston një përputhje totale e mbarë subjekteve politike të Kosovës për zgjidhjen e problemeve të "Trepçës" me qëllim të rimëkëmbjes së saj



Minatorët e "Trepçës" të impresionar me enterierin e sallës së Kuvendit

Në shenjë të 15- vjetorit të Grevës së Minatorëve të "Trepçës", një delegacion i minatorëve të Stan Tërgut vizitoi Kuvendin e Kosovës, ku u pritën nga anëtari i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, prof.dr. Fatmir Sejdiu. Udhëheqja e këtij delegacioni me këtë rast prezantoi përpjekjet që kanë bërë punonjësit e këtushëm për të kryer disa punë kapitale që mundësuan shpëtimin e minierës nga përmbytja e ujërave. Tani në këtë minerë punojnë 527 punëtorë, ndërsa brengos fakti se 787 të tjerë kanë shkuar në pension të parakohshëm me një pension shumë të ulët, që nuk mjafton për të siguruar as ekzistencën, kurse mbi 300 minatorë nën moshën 50 vjeçare kanë mbetur të pasistemuar në punë. Këto të dhëna tregojnë për pozitën e vështirë të minatorëve të këtij gjiganti ekonomik të Kosovës. Minatorët apelonin te organi më i lartë ligjvënës dhe mbarë shoqëria kosovare që të gjendet një zgjidhje për minatorët që bënë aq shumë për Kosovën, ndërsa sot një pjesë e madhe e tyre vujanë për kafshatën e gojës. Megjithatë, ata edhe në këtë pozitë të vështirë, kërkonin që Kuvendi i Kosovës t' u japë përparësi ligjeve bazike, duke u angazhuar për zgjidhje sistemore për të gjithë punonjësit dhe qytetarët e Kosovës. Duke përkujtuar se greva e minatorëve të "Trepçës" është një ngjarje e madhe me një vlerë të pazëvendësueshme, prof. dr. Fatmir Sejdiu theksoi se ekziston një përputhje totale e mbarë subjekteve politike të Kosovës për zgjidhjen e problemeve të "Trepçës" me qëllim të rimëkëmbjes së saj, duke ditur rëndësinë e këtij kompleksi për zhvillimin e ardhshëm të Kosovës. Në këtë aspekt duhet të angazhohemi të gjithë, theksoi Sejdiu, jo vetëm në këtë kolektiv, por edhe më gjerë në shoqëri, sepse me punën tonë duhet të dëshmojmë se jemi të denjë për pavarësinë dhe shtetin tonë, derisa në këtë drejtim kemi edhe përkrahjen e faktorit ndërkombëtar. Për të arritur këtë duhet të kemi legjislacion të qëndrueshëm, duke intensifikuar në të njëjtën kohë edhe procesin e privatizimit. Delegacioni i minatorëve të "Trepçës" me këtë rast vizitoi edhe sallën e renovuar të Kuvendit të Kosovës. Drejtori i administratës së "Trepçës" Riza Musliu, duke shprehur përshtypjet e tij impresionuese, tha se jemi të mahnitur me pamjen e re të ndërtesës së Kuvendit të Kosovës.

Projektligji për kinematografinë - nxitje për prodhimtari më të begatshme filmore

Të krijohet një bazë për prodhimtari sa më cilësore filmore, brenda një hapësire e mekanizmi sa më të decentralizuar, duke gëzuar njëkohësisht edhe mbështetje financiare

Krijimi i një baze sa më të mirë për prodhimin, distribuimin dhe shfaqjen e filmave, nxitja dhe mbështetja e prodhimit vendës të filmit, motivimi dhe mbështetja e aktiviteteve për modernizimin dhe zgjerimin e rrjetit të kinemave, krijimi dhe ruajtja e lëndës filmike arkivore, mbështetja e



Edi Shukriu

kineastëve të rinj të talentuar, përsosja e të gjithë elementëve të kinematografisë, përbëjnë disa nga synimet më kryesore të Projektligjit për Kinematografinë, për të cilin u mbajt një dëgjim publik, organizuar nga Komisioni për Kulturë, Rini dhe Sport i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga dr. Edi Shukriu, kryetare.

Pjesa më e madhe e diskutuesve mëtonin drejt pasurimit të ligjit me propozime të atilla, që ai të jetë një bazë për prodhimtari sa më cilësore filmore, që do të krijohej brenda një hapësire e mekanizmi sa më të decentralizuar, duke gëzuar njëkohësisht edhe mbështetje financiare. Një theks të veçantë diskutuesit i kushtonin çështjes së statusit, pozitës dhe trajtimit të Kosova Filmit, Qendrës Kinematografike të Kosovës, si dhe distribuimit të filmit në tekstin e projektligjit, duke vënë në pah se formimi i Qendrës Kinematografike dhe krijimi i Fondit për kinematografi do të ishin të një rëndësie të veçantë. Gjatë debatit rreth këtyre çështjeve të diskutues vërehej një dozë frike se mos projektligji krijon mundësi për monopol, do të thotë krijimtaria filmore të kontrollohet madje edhe nga pikëpamja ideoestetike nga ana e administratës së Ministrisë së Kulturës. Në këtë vështrim ata kërkonin që bordi artistik dhe mekanizma të tjerë të vendosjes rreth çështjes së prodhimit të filmit të mos emërohen nga ministria.

Kosova vazhdon përfshirjen e saj në rendin juridik ndërkombëtar dhe në integrimet euro-atlantike

Ajo që është shumë e rëndësishme në këtë Projektligj dhe që figuron në dispozitat kalimtare është fakti se ligji parasheh formimin e një zyre të Kosovës pranë Tribunalit të Hagës, që është shumë pozitive, meqenëse zyre të tilla kanë formuar shtetet tjera, vetëm Kosova nuk ka. Është mirë që ligji ka paraparë që të formohet kjo zyrë, e cila në një mënyrë do të ketë mundësi edhe të bashkëpunojë drejtpërdrejt me këtë institucion, duke ofruar edhe ndihmën e nevojshme juridike për qytetarët e Kosovës

Në mbledhjen e 18 dhjetorit Kuvendi i Kosovës bëri shqyrtimin e parë të Projektligjit për bashkëpunimin e Kosovës me Tribunalin Penal të Hagës. Me këtë rast ekspozenë për këtë çështje e paraqiti kryeministri i Qeverisë së Kosovës, Bajram Rexhepi.



Bajram Rexhepi

Pasi përmendi faktin se Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë nismën për përgatitjen e Projektligjit për bashkëpunim të Kosovës me Tribunalin Penal të Hagës, Rexhepi theksoi se përgatitja e këtij Projektligji është nxitur nga një varg arsyesh. Jemi nisur nga maksima juridike se të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe konform kësaj maksime duhet të sigurohen parakushtet e duhura, që të gjithë qytetarëve të Kosovës t'iu mundësohet të jetojnë të lirë e të sigurt dhe mbrojtja ligjore në rast të përbaljes me akuza para gjyqit. Jemi nxitur në përgatitjen e këtij Projektligji gjithashtu edhe nga nevoja që të pengohen sjelljet dhe veprimet arbitrare të organeve të ndjekjes dhe jo vetëm të tyre. Jemi nxitur gjithashtu edhe nga aktualiteti kosovar i cili mbështetet në faktin se Kosova është e gatshme të ballafaqohet me të gjitha sfidat që paraqiten, si pengesë në sigurimin e mirëqenies së njerëzve dhe zbatimin e të gjitha lirive dhe të drejtave të garantuara me aktet juridike relevante, si vendëse, ashtu edhe me

Projektligji në mes tjerash përmban dispozitat për:

- sigurimin e kushteve teknike dhe lehtësimin e punës së Zyrës së Tribunalit Penal të Hagës, e cila vepron në territorin e Kosovës;
- transferimin e procedurës penale në Tribunalin Penal të Hagës, kur vepra hyn në kompetencë të Tribunalit Penal të Hagës;
- ndalimin e gjykimit të serishëm pranë organeve kompetente të Kosovës, atëherë kur kryesi një herë është gjykuar dhe është vendosur rasti nga Tribunali Penal i Hagës;
- ekzekutimin e kërkesës së Tribunalit Penal të Hagës për dorëzimin e të pandehurit;
- ofrimin e ndihmës juridike Tribunalit Penal të Hagës që do ta bëjnë organet kompetente të Kosovës, duke përfshirë edhe gatishmërinë për lidhjen e marrëveshjeve që kanë të bëjnë me ekzekutimin e dënimit të shqiptuar.

aktet ndërkombëtare.

Ky Projektligj është përgatitur me pjesëmarrjen aktive të ekspertëve mjaft të shquar vendës, duke mos lënë anash edhe ndihmën, përkrahjen dhe bashkëpunimin e ekspertëve ndërkombëtarë në Zyrën ligjore të UNMIK-ut.

Në këtë Projektligj përmbushet edhe një pjesë e obligimeve që dalin nga Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme të Kosovës, përkatësisht dispozitës 5.7 që përcakton obligimin e harmonizimit të akteve vendëse me ato ndërkombëtare. Po ashtu, ky Projektligj është i bazuar dhe harmonizuar edhe me Statutin e Tribunalit të Hagës dhe rregulloret tjera të procedurës së Tribunalit të Hagës.

Projektligji shpreh gatishmërinë e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes së Kosovës për të bashkëpunuar me Tribunalin e Hagës dhe kryerjen e obligimeve që

burojnë nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit Numër 827/1993.

Ky Projektligj i mundëson Kosovës që drejtpërdrejt të vazhdojë kontributin në vendosjen e paqes dhe stabilitetit në rajon. Gjithashtu, përmes këtij Projektligji synohet vendosja e bashkëpunimit me Tribunalin e Hagës, pa anashkalim të institucioneve vendëse dhe me një rol përmbajtësor të këtyre institucioneve.

Mbështetur në atë që theksova më lart, konsideroj se Projektligji rregullon çështjet komplekse dhe në veçanti bashkëpunimin reciprok në procesin e ndjekjes dhe shqiptimin e dënimit të kryerësit për vrasje të qëllimta, torturë apo trajtim çnjerëzor, deportim i jashtëligjshëm, marrje peng etj. Me këtë, Kosova njëkohësisht vazhdon përfshirjen e saj në zhvillimin e rendit juridik ndërkombëtar dhe në integrimet euro-atlantike.

Duke përfunduar Bajram Rexhepi ju propozoi deputetëve që ta aprovojnë këtë Projektligj, i cili do të jetë në funksion të zbatimit të drejtësisë.

Të veprohet sipas procedurave të rregullta

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti **Alush Gashi** bëri disa vërejtje. Në rendin e ditës, të cilin ne e kemi marrë, flitet për shqyrtimin e Projektlegjisacionit. Nuk shkruan se është shqyrtimi i parë i Projektligjit. Ndërsa, nga i nderuari kryeministër ne dëgjojmë për Projektligj. Në këtë material, i cili na ofrohet këtu, përshkruhet një procedurë pak më ndryshe se sa procedurat të cilat ne i kemi gjatë miratimit të ligjeve.

Andaj, kërkojmë sqarime - pse lidhur me këtë çështje ne nuk miratojmë ligj, por përdoret një term krejt tjetër.

E dyta. Në Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e kemi shqyrtuar, me shumë vëmendje këtë çështje. Dhe rekomandimi i trajtimit të kësaj çështjeje dallon prej trajtimit të projektligjeve dhe ligjeve që ne i miratojmë.

Këtu, në mes tjerash sygjerohet - që ne këtu mund të japim amendamente, që t'ia përcjellim Qeverisë e Qeveria amendamentet t'ia përcjellë Përfaqësuesit special. Mendoj se kjo nuk është një rrugë e cila përkon me procedurat e Kuvendit të Kosovës.

Mendoj se kjo materie duhet të trajtohet sipas procedurave të rregullta, të jetë leximi i parë, puna në komision, leximi i dytë, votimi dhe pastaj të shkojë në procedurë të mëtutjeshme për miratim eventual.

Arsim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së i dha mbështetje parimore kësaj nisme, por duke kërkuar që para se të shqyrtohet ligji në leximin e dytë, të sqarohen disa çështje.

Çështja e parë, ajo që u ngrit, është çështja e natyrës së aktit. Vërtet në propozimin formal që i ka ardhur Parlamentit propozohet shqyrtimi i Projektlegjisacionit, pra një akti që nuk dihet a është rregullore e UNMIK-ut a është ligj i Kuvendit të

Kosovës. Mendoj se ky Kuvend nuk ka nevojë për t'i shqyrtuar rregulloret e UNMIK-ut. Rregulloret e UNMIK-ut i bie Përfaqësuesi special dhe propozoj që ky akt të quhet ligj. Ligj, që do t'i nënshtrohet procedurës së rregullt ligjvënëse, pra - leximi i parë; leximi i dytë dhe procedurat tjera.

Nevoja për këtë ligj është e justifikueshme, meqenëse Kosova përmes këtij ligji po institucionalizon bashkëpunimin e saj me Tribunalin e Hagës. Pra, ky bashkëpunim që deri më tani nuk ka qenë i institucionalizuar tani po institucionalizohet dhe Kosova po bëhet një lloj partneri me Tribunalin e Hagës që është shumë pozitive, duke pasur parasysh edhe problemet që janë paraqitur më herët, sidomos problemet rreth rastit Limaj, kur një dorëzim apo një paraqitje vullnetare e tij në Tribunalin e Hagës u kualifikua si një arrestim dhe për këtë ka nevojë që të kemi këtë ligj i cili përcakton edhe procedurat se si procedohet me kërkesën e Tribunalit të Hagës.

Çështja e dytë që ka mbetur e pasqaruar në propozimin e këtij Projektligji është çështja e autoritetit kompetent. Kush është partner apo autoritet kompetent që të bashkëpunojë me Tribunalin e Hagës? A është Përfaqësues special i Sekretarit të përgjithshëm apo është Qeveria e Kosovës?

Meqenëse Qeveria e Kosovës po sponsoron këtë ligj, ajo duhet të jetë autoriteti kompetent. Dikush mund të thotë: po nuk do të pajtohet Përfaqësuesi Special! Ne po bëjmë ligj këtu për Kosovën dhe mendoj se Qeveria e Kosovës duhet të prezantojë si një partner i cili merr përgjegjësinë për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës.

Ajo që është shumë e rëndësishme në këtë Projektligj dhe që figuron në dispozitat kalimtare është fakti se ligji parasheh formimin e një zyre të Kosovës pranë Tribunalit të Hagës, që është shumë pozitive, meqenëse zyre të tilla kanë formuar shtetet tjera, vetëm Kosova nuk ka.

Në emër të koalicionit "Kthimi" deputetja **Liljana Keniq** tha se ky ligj i propozuar nga Qeveria nuk ka nevojë për shumë diskutime dhe dilema kur thuhet bashkëpunimi i nevojshëm me Tribunalin e Hagës.

Bashkëpunimi me Tribunalin e Hagës thjeshtë nënkupton një bashkëpunim të hapur, të sinqertë dhe të plotë për viktimat dhe familjet që kanë mbetur pa më të dashurit e tyre.

Koalicioni "Kthimi" ka herë ka propozuar që ky Kuvend ta miratojë një Rezolutë për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës. Pra, dorëzimin e të gjithë atyre që kanë bërë krime, pavarësisht prej përkatësisë etnike.

Atë që do ta paraqes si problem lidhur me këtë rregullativë është si vijon: se në memorandumun e Qeverisë theksohet nevoja e bashkëpunimit institucional të Kosovës me Tribunalin e Hagës, për krimet e bëra vetëm gjatë luftës në Kosovë. Është e pakuptueshme fshehja e krimeve të bëra ndaj serbëve pas konfliktit, gjegjësisht pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës, krime këto të bëra para UNMIK-ut, KFOR-it dhe përfaqësuesve të Bashkësisë ndërkom-bëtare.

Ne nuk do të pajtohemi me propozimin e Qeverisë që bashkëpunimi të jetë vetëm në dorëzimin e të akuzuarve për krimet e bëra gjatë luftës.

Me një sjellje të tillë, përveç tjerash, hapet edhe çështja e aspektit jonjerëzor dhe fyes të përfaqësuesve të Qeverisë së Kosovës ndaj popullit serb.

Problem paraqet edhe forma që e propozon Qeveria. Mendoj se rregullimi i kësaj materie bie në kompetencë të PSSP-së. Ky Kuvend duhet të miratojë Rezolutën për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës, në shenjë përkrahjeje UNMIK-ut dhe KFOR-it për arrestimin e të akuzuarve, kështu që në bazë të një rezolute të tillë, UNMIK-u gjegjësisht PSSP, me plotësim të nevojshme, të shpallë urdhëresën përmes së cilës do ta rregullojë këtë

lëmë për çka është i autorizuar në pajtim me Kreun 8.1.i.i.o.

Bujar Dugolli, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, theksoi se edhe ky Projektligj, si shumë ligje të tjera, i kanë munguar Kosovës dhe mungesa e tyre i ka kushtuar shumë, sidomos për lëmin të cilin ne po e diskutojmë.

Ne, edhe më herët, edhe si institucione edhe si Kuvend, jemi deklaruar për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës, por këtë e kemi precizuar edhe me një deklaratë të mëherëshme se ky bashkëpunim duhet të ekzistojë dhe funksionojë konform ligjit që do ta miratojë Kuvendi i Kosovës. Dhe është një punë e Qeverisë, me ndihmën e atyre ekspertëve që janë cekur, që Kuvendit i kanë sjellë në diskutim parimor Projektligjin, sepse unë ashtu po dua ta quaj dhe jo ashtu siç figuron - legjislacion, sepse ne miratojmë ligje, që rregullojnë këtë materie.

Jemi dëshmitarë të veprimeve të pasluftës në Kosovë, se Tribunali i Hagës nuk i ka respektuar institucionet e Kosovës dhe qytetarët e Kosovës që janë akuzuar nga Tribunali i Hagës. Ky mosrespektim konsiderojmë vinte për shkak se ne nuk kishim më parë të miratuar ligjin e Kosovës për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës, ndërsa Tribunali i Hagës njihte ligjin e Serbisë për bashkëpunim me Tribunalin edhe mbi territorin e Kosovës, gjë që për ne është një absurd i llojit të vet dhe që ende mbetet absurd që nuk është zgjidhur. Shpresojmë se pas miratimit të këtij ligji gjërat në këtë fushë të ndjeshme do të ndryshojnë pozitivisht.

Të përcaktohet me ligj bartësi i bashkëpunimit me Tribunalin Penal të Hagës

Ramadan Kelmendi theksoi se propozimligji me plotë të drejtë e klasifikon atë që ka ndodhur në Kosovë si luftë, sepse e tillë ishte, përkundër tendencave që kjo luftë të trajtohet si konflikt. Natyrisht, megjithë respektin për grupin

punues dhe vlerën e propozimligjit, është dashur që të përcaktohet me ligj bartësi i bashkëpunimit me Tribunalin Penal të Hagës e jo të lihet përkufizimi i papërkufizuar dhe autoriteti kompetent. Dhe kjo përsëritet në tërë propozimligjin edhe pse kjo nënkupohet, nga se në natyrën e ligjit nuk mund të qëndrojnë nënkuptimet, dilemat dhe interpretimet subjektive. Bashkëpunimi me Tribunalin e Hagës bëhet në forma të ndryshme, por bashkëpunimi ndryshon prej komunikimit i cili është përsëritur këtu në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Propozimligji, kur flet për kompetencat e autoritetit kompetent, nuk përcakton se cilat janë masat adekuate për këtë bashkëpunim nga se Tribunali i Hagës nëse nuk përcakton këto masa, atëherë mund të trajtohem se nuk bashkëpunojmë sa duhet ose në nivele të kërkuara. Propozimligji nuk përcakton kushtet kur procedura penale që zhvillohet pranë gjykatave në Kosovë mund të transferohet në Tribunalin Penal të Hagës, si dhe rastet kur ndonjë person është gjykuar në Kosovë për një vepër penale, ndaj për të njëjtën vepër është e padrejtë të dërgohet në rigjykim në Tribunalin Penal të Hagës. Në propozimligj duhet qartas të përcaktohet shkalla e veprës penale e cila hyn në kompetencat e Tribunalit Penal të Hagës dhe cila vepër penale mund të transferohet. Vlerësoj se afati i të drejtës për të ushtruar ankesën prej 8 ditësh kundër aktgjykimit për transfer është i shkurtër, jo i drejtë dhe joreal në rrethanat procedurale.

Në këtë propozimligj të bashkëpunimit nuk është përcaktuar se si të veprohet në raste kur gjykata e Kosovës për të njëjtën vepër penale liron apo pushon procedurën në mungesë të fakteve, ndërsa për të njëjtën Tribunali i Hagës kërkon transfer.

Rendi kushtetues dhe të drejtat kombëtare e njerëzore të qytetarëve të Kosovës ishin rrënuar me dhunë

Hydajet Hyseni shtroi pyetjen se nëse u dashka që Përfaqësuesi spe-

cial ta finalizojë, do të thotë të jetë bartës i këtij dokumenti, pse nuk vjen ai të na informojë dhe ta bindë Kuvendin. Ç'është kjo mënyrë komunikimi me Kuvendin? Pse anashkalohet e s'komunikohet në vijimësi trupi ligjvënës?

Kosova dhe populli i saj ishin viktimë e agresionit të politikave gjenocidale antishqiptare dhe rrjedhimisht Kosova dhe populli i saj janë akuzues dhe jo të akuzuar.

Sa i përket kohës, ligji nuk e përcakton këtë propozim krejt qartas, por Rezoluta 827 e vitit 93, të cilës ky dokument i referohet, mbulon periudhën prej vitit 91 e këndeje. Mendoj se periudha prej vitit 91 nuk do të duhej lënë anash.

Rendi kushtetues dhe të drejtat kombëtare e njerëzore të qytetarëve të Kosovës janë rrënuar me dhunë dhe në mënyrë antikushtetuese dhe për pasojë - rezistenca ndaj një politike të tillë, ka qenë jo vetëm e drejtë, por edhe detyrë e obligim qytetar e kushtetues, në përputhje jo vetëm me ish-kushtetutën e Kosovës, e cila shprehimisht e obligon qytetarin e Kosovës, por edhe me dokumentet e mirënjohura ndërkombëtare. Lufta çlirimtare nuk mund të barazohet në asnjë rast, në asnjë mënyrë me dhunën gjenocidale shoveniste.

Dokumenti i Rambujesë, të cilit i referohet edhe Rezoluta 1244 dhe Korniza Kushtetuese, sigurisht duke marrë parasysh sa u tha më lart, parashohin shpalljen e amnistisë për luftëtarët e lirisë kundër të cilëve është ngritur procedurë penale dhe lirim e të burgosurve të pengjeve të luftës.

Dhe, së fundi, një çështje që ka të bëjë më shumë me raportet midis nesh dhe me një prirje po ashtu tejet djallëzore për ta përqëndruar sa për fillim gjithë sherrin këtu, midis nesh. Siç dihet vite më parë, rinia dhe intelektualët atdhetarë të Kosovës inicuan dhe kurorëzuan me sukses të paparë një lëvizje të gjerë e të fuqishme të pajtimit dhe zhdokjes së konflikteve dhe hasmërive të së kaluarës, në funksion të një të ardhme të lirë e të lumtur për të gjithë Kosovën.

Po në shërbim të një të ardhmeje të tillë, të lirë, të pavarur e të lumtur, do të duhej të prireshim edhe më tej nga filozofia e pajtimit kombëtar, zbutjes dhe zhdukjes së konflikteve e armiqtësive të vjetra dhe parandalimit të të rejave, parandalimi dhe mundësimi i formave famkëqia të luftës speciale, në shpifje, trillime, fabrikime faktesh të paqena e dëshmish të rrejshme. Vetëm nëse bashkëpunojmë siç duhet mes nesh, mund të bashkëpunojmë me sukses edhe me botën.

Smajl Latifi theksoi se ne ende s'kemi argumente bindëse që të besojmë se Tribunali për krime luftime në ish-Jugosllavi me seli në Hagë është institucion i mirëfilltë i drejtësisë dhe mbështetet plotësisht në parimet e vërteta të drejtësisë njerëzore. Ne ende kemi në dorë plot argumente bindëse në funksion të kthjellimit të gjykimit tonë, të cilat i vënë në pah elementet komponente dhe veçoritë karakteristike politike të njëanshme në vazhdimësi, posaçërisht kur kemi të bëjmë me rastin e Kosovës dhe qëndrimin të këtij Tribunali rreth saj. Ne do të kemi të drejtë gjithnjë të bëjmë komente po ashtu politike sa kohë që Tribunali dhe puna e tij karakterizohet me qëndrime të pas-tra politike dhe zbaton praktika që çojnë nga një tendencë tepër e dëmshme dhe të padrejtë dhe një lloj barasvlerësimi midis krimit dhe kriminelëve me luftën çlirimtare dhe liridashësve. Ne ende kemi të drejtë të themi se Tribunali i Hagës vazhdon të shpërblejë edhe luftën çlirimtare të një populli duke i vënë në bankën e akuzës bartësit e saj. Ata që luftuan për liri e vetëvendosje të kombeve të tyre për drejtësinë e vërtetë vazhdojnë të jenë objekt i përndjekjeve, arrestimeve, gjyqimeve, dënimeve nga gjykatat e UNMIK-ut në Kosovë dhe ajo e Hagës. Njëkohësisht nuk është vështirë të konstatohet se Tribunali dhe gjykatat e UNMIK-ut vazhdojnë ta mëshirojnë shtetin, pushtetin, aparatit dhe strukturat vartëse të tij që udhëhoqën në mënyrë të orga-

nizuar, të programuar krime, dhunë çnjerëzore, gjenocid të bazuar edhe në platforma të njohura për ne dhe për ndërkombëtarët.

Mevlyde Saraçi tha se në Kosovë ka gjurmë të krimit dhe argumente të mjaftueshme të cilat ende kanë mbetur të pahetuara nga organet kompetente në Kosovë, por edhe nga vetë Tribunali i Hagës. Fakti tjetër është se në Kosovë ende nuk janë hapur të gjitha varrezat masive. Gjithashtu kufomat e ekzaminuara ende po qëndrojnë në Serbi dhe po riatdhesohen kohëpaskohe në numër shumë të vogël. Edhe kjo është një formë e kriminalizimit të familjeve që presin zbardhjen e fatit të personave të humbur, e që duhet të formohen këto grupe apo komitete për të hetuar shkaktarët që pengojnë këtë proces.

Ne jemi dëshmitarë se në Kosovë edhe po hapen disa varreza masive pa bashkëpunuar fare me institucionet e Kosovës. Prandaj, ky material, mendoj se nuk e meriton sot të aprovohet në parim. Ne duhet të bisedojmë edhe më tutje në bazë të Rregullores së punës, të sjellim vërejtjet tona me shkrim dhe gjithsesi ky të dalë projektligj i amendamentuar dhe i aprovuar nga ky Kuvend. Ndryshe, nuk mund t'i lahem borxhit popullatës së Kosovës që ka përjetuar krimet më të rënda në historinë e vet.

Hasan Meta theksoi se pajtohem me të gjithë parafolësit që për qytetarët të cilët do të akuzohen nga Tribunali i Hagës - institucionet kosovare duhet ta marrin përgjegjësinë dhe të qëndrojnë ashtu si duhet, si nëpër shtetet tjera. Por, propozimi do të jetë kështu: që ky të vijë si material i duhur nëse duam ligj për këtë dhe t'i ndjekë procedurat e zakonshme, që janë në Kuvendin e Kosovës.

Dragisha Kërstoviq bëri me dije se seriozisht proteston për shumë gjëra që u theksuan në këtë foltore për Projektligjin për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës. Mendoj se aspak nuk ka kuptim që Tribunali i Hagës ,si institucion ndërkombëtar,

të vëhet në pyetje dhe deputetët të mos besojnë se ky institucion është institucion i drejtësisë.

Mendoj se në këtë Kuvend, edhe pse nxirret Ligji për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës, nuk mund të miratohet ligji i cili nuk do të jetë akt i përgjithshëm. Përkundrazi, ai duhet të jetë akt i përgjithshëm dhe nuk mund të jetë ligj i paraparë vetëm për përgjegjësinë e pjesëtarëve të një bashkësie etnike dhe në të njëjtën kohë të mbrojtë pjesëtarët e bashkësisë tjetër etnike. Kjo, thjeshtë nuk mund të bëhet, për shkak se dikush që është i autorizuar një diçka të tillë nuk mund ta pengojë.

Xhavit Haliti, theksoi se megjithë përpjekjet që ta ligjësojmë institucionalisht përmes Qeverisë së Kosovës këtë ligj, unë më shumë e shoh si një rregullore e cila në njëfarë forme do të kalojë përmes zotit Hollkeri. Megjithatë, mendoj se Zyra ligjore e UNMIK-ut dhe zoti Hollkeri duhet ta kenë parasysh se kosovarët po kërkojnë që ky ligj të institucionalizohet, të akuzuarit të cilët do t'i nënshtrohen Gjykatës së Hagës, kushdoqofshin ata, të gëzojnë dinjitet dhe të mos shkelen të drejtat e tyre.

Gani Koci propozoi që Qeveria në kuadër të bashkëpunimit me Tribunalin e Hagës do të duhej të përcaktojë detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë e saj si Qeveri në mbrojtjen, po them, ose në ofrimin e ndihmës juridike dhe financiare në mbrojtjen e të akuzuarve në Tribunalin e Hagës. Kjo nuk është diçka e re, kjo është aplikuar edhe në shtetet tjera që kanë miratuar ligje të tilla dhe unë, me asnjë dispozitë të këtij Projektligji, nuk kam parë se Qeveria merr një obligim të tillë që të akuzuarve në Tribunalin e Hagës t'u ofrohet një asistencë edhe materiale, edhe juridike, edhe financiare. Prandaj, kjo duhet të jetë pjesë e këtij Projektligji.

Pas këtij shqyrtimi, në mbledhjen e 19 shkurtit deputetët aprovuan Ligjin për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës

Parlamentarët kosovarë thellojnë bashkëpunimin me parlamentarët e Shqipërisë

Autostrada Durrës- Morinë- Prizren -Merdare përbën një aortë të pazëvendësueshme të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë dhe Kosovës, të ndërlidhjes e integritimeve shqiptare, si dhe një mundësi për bashkëpunim edhe më të shumanshëm ndërmjet të të dyja vendeve

Komisioni për Transport dhe Telekomunikacion i Kuvendit të Kosovës i udhëhequr nga z. Edita Tahiri, kryetare, ishte në vizitë pesëditëshe zyrtare në Shqipëri, me ftesë të komisionit për Industri dhe Transport të Kuvendit të Shqipërisë. Ky komision zhvilloi një sërë takimesh me strukturat përkatëse të Kuvendit dhe të Qeverisë së Shqipërisë. Komisioni pati takime me kryetarin e Kuvendit të Shqipërisë, z. Servet Pëllumbi, zëvendëskryetaren e Kuvendit të Shqipërisë, z. Magbule Çeço, ministrin e Transportit dhe industrisë, z. Spartak Poçi, me kryetarin Komisionit për Industri dhe Transport, z. Eduard Alushi dhe anëtarët e Komisionit, nënkryetarin e Komisionit për Politikë të Jashtme të Kuvendit, z. Besnik Mustafaj, me drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të Shqipërisë z. Engjëll Caka, drejtorin e përgjithshëm të Telekomit të Shqipërisë, Ferhat Lukaçaj dhe drejtorin e departamentit të telekomunikacionit pranë Ministrisë, z. Apostol Noti dhe me drejtoreshën e Postave të Shqipërisë, z. Aleksandra Çollakun. Në përbërje të delegacionit të Kosovës ishin edhe deputetët Qazim Kabashi, Jusuf Sutaj, Hatixhe Hoxha, Ilmi Ahmeti, Sabri Fejzullahu dhe Sahit Krasniqi, koordinatoreja e Komisionit Advije Morina dhe drejtori i buxhetit të Kuvendit, Jusuf Nikçi.

Në takimin me kryetarin e Kuvendit të Shqipërisë, zoti Servet Pëllumbi, e cila u zhvillua gjatë një darke pune në një atmosferë të shumë të ngrohtë, u këmbyen pikëpamje rreth çështjeve vitale nacionale të të dyja vendeve me theks të vecantë për sfidat më prioritare. Zoti Pëllumbi theksoi me këtë rast se çështja e Kosovës dhe zgjidhja e drejtë e saj mbetet prioritet i lartë në agjendën e institucioneve të Shqipërisë, duke potencuar angazhimet e



Pamje nga takimi në Komisionin e industrisë dhe transportit të Shqipërisë

vazhdueshme në këtë drejtim. Nga ana e saj zonja Edita Tahiri, foli për proceset politike në Kosovë, duke përfshirë çështjen e implementimit të standardeve si dhe për rolin kyq të pavarësisë së Kosovës në zhvillimet e gjithëmbarshme të vendit. Në takimin me z. Makbule Çeço komisioni u njoftua me punën dhe strukturën e Kuvendit të Shqipërisë, si dhe me procedurën lëgjvënëse. Z. Edita Tahiri foli me këtë rast për angazhimet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen komisionet dhe Kuvendi i Kosovës në fushën e aprovimit të ligjeve. Ajo vuri në spikamë edhe disa nga detyrat më aktuale të deputetëve kosovarë për të ngritur efektshmërinë dhe cilësinë në lëmin e ligjeve dhe të monitorimit të institucioneve të qeverisjes.

Në Takimin me Ministrin e industrisë dhe transporteve zoti Spartak Poçi, parlamentarët kosovarë u njoftuan nga ana e ministrit Poçi me prioritetet që ka Shqipëria në lidhjet infrastrukturore me vendet e rajonit, si dhe me përpjekjet për modernizim të rrugëve, hekurudhave, telekomunikacionit, porteve detare dhe transportit ajror në Shqipëri. U theksua se rruga Durrës - Prishtinë është me rëndësi jetike, jo vetëm për Shqipërinë dhe Kosovën, por edhe më gjerë për rajonin. Kjo rrugë u tha se përbën një aortë të pazëvendësueshme të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë dhe Kosovës, të ndërlidhjes dhe integritimeve shqiptare, si dhe një mundësi për bashkëpunim e ndërlidhje më të shumanshme të të dyja vendeve. Zonja Tahiri foli edhe për sfidat e Kosovës në lëmin e transportit dhe telekomunikacionit, në mënyrë të veçantë për nismat e liberalizimit në fushën e telekomunikacionit dhe perspektivat në fushën transporteve të Kosovës.



Takimi i parlamentarëve kosovarë me ministrin Spartak Poçi

>>>>

<<<<

Interesim të veçantë në takimin me Komisionin për industri dhe transport u tregua për intensifikimin e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët për të dyja komisionet. Kryetari i këtij Komisioni, z. Eduard Alushi u angazhua për një interakcion më të rregullt mes dy komisioneve duke premtuar një vizitë të shpejtë në Kosovë. Edhe në takimin me z. Besnik Mustafaj u tha se është e nevojshme të thellohet bashkëpunimi ndërmjet të dyja vendeve në të gjitha nivelet. Shqipëria gjithnjë e ka përkrahur dhe do ta përkrahë Kosovën në ballafaqimin me sfidat aktuale, sidomos për hapje më të madhe të Kosovës drejt integritimeve evropiane e botërore, për të arritur qëllimet dhe persepektivat e duhura. Në këtë vështrim u angazhua edhe z. Edita Tahiri, e cila theksoi se Shqipëria duhet të jetë më aktive për përkrahjen e Kosovës në institucionet ndërkombëtare.

Autostrada ishte në qendër të vëmendjes edhe në takimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve të Shqipërisë, ku u tha se autostrada është paraparë të kryhet brenda katër vjetësh. Ndërsa një pjesë e punëve tashmë është kryer. Deri tash, për fazën e për të këtij projekti janë siguruar 30 milionë euro nga tatimet dhe kreditë ndërkombëtare.

Në takimin në Drejtorinë e Telekomit u diskutua për projektin e instalimit të kabllit optik Shqipëri - Kosovë për telefoni mobile dhe internet, në mënyrë që të mos ketë nevojë që lidhja të merret nga Monakoja ose ndonjë vend tjetër. Kjo do të ishte në dobi të dyanshme.

Ndërkaq, në Drejtorinë e Postës u tha se është e nevojshme ngritja e efkasitetit të shërbimeve ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.

Pos këtyre takimeve komisioni kosovar pati edhe një varg aktiviteteve të tjera. Komisioni mori pjesë në një mbledhje të Kuvendit të Shqipërisë, vizitoi Krujën, Vlorën etj.

Për suksesin e kësaj vizite Komisioni dëshiron të falënderoi në mënyrë të veçantë, ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, z. Bashkim Rama i cili u angazhua për realizimin e kësaj vizite.

Celal Ilyas

NJË GRUP STUDENTËSH TË DALLUAR NGA BOTA VIZITON PARLAMENTIN E KOSOVËS

Politika e Beogradit po reflektohet negativisht në proceset në Kosovë

Pas gjithë asaj që kemi përjetuar në atë luftë tmerrësisht të ndyrë, me aq vrasje e dhunime, është vështirë që njeriu të jetë tolerues, por duhet të gjejmë forcë për të ecur përpara, sepse këtë ua kemi borxh brezave që vijnë, theksoi Flora Brovina

Një grup studentësh nga Evropa dhe Amerika që ndodhen para magistraturës, të zgjedhur nga organizata VUS e Austrisë, në kuadër të vizitës që po bëjnë në Kosovë, sot ishin mysafirë në Kuvendin e Kosovës. Me këtë rast ata u njohën me punën e Parlamentit të



Flora Brovina në bisedë me studentët

Kosovës, proceset aktuale në Kosovë, strukturën e Parlamentit, me sfidat me të cilat ballafaqohet ai, si dhe me rezultatet që po arrin në fushën e legjislacionit dhe në lëmenj të tjerë. Gjatë kësaj vizite grupi i studentëve pati takime me Nekibe Kelmendin, Flora Brovinën, Edita Tahirin, Rada Trajkoviçin, Milorad Todoroviçin dhe Resmie Mumxhiun. Në takimin me këtë grup studentësh deputetja dhe humanistja Flora Brovina i njohu ata me luftën çlirimtare të Kosovës, e cila ishte humane, ashtu si ishte edhe intervenimi i bashkësisë ndërkombëtare për të shpëtuar një popull nga gjenocidi. Kosova këtë luftë e pagoi me jetëra njerëzish, ndërsa bota e pagoi materialisht. Plagët e luftës për fat të keq ende janë të hapura, theksoi Brovina, pasi edhe më tutje në Beograd gjenden 800 kufoma të të zhdukurve kosovarë nga varrezat masive të Batajnicës, kthimi i të cilave varet nga presioni i botës mbi Beogradin dhe nga vullneti i Serbisë. Pos këtyre edhe 3200 veta të tjerë konsiderohen të zhdukur. Jemi përcaktuar njëkohësisht edhe për zbardhjen e fatit të të

zhdukurve edhe nga radhët e pjesëtarëve serbë, pa marrë parasysh rolin e tyre në luftë. Pas gjithë asaj që kemi përjetuar në atë luftë tmerrësisht të ndyrë me aq vrasje e dhunime, është vështirë që njeriu të jetë tolerues, por duhet të gjejmë forcë për të ecur përpara, sepse këtë ua kemi borxh brezave që vijnë. Mirëpo, në këtë rrjedhë paraqitet sërish politika e Beogradit, e cila edhe më tutje dirigjon me serbët e Kosovës, madje ajo reflektohet mjaft negativisht edhe në proceset e privatizimit në Kosovë, pa të cilin nuk mund të ketë prosperitet në Kosovë.

Megjithatë të gjitha këto nuk na dekurajojnë që të angazhohemi që të gjithë pjestëtarët e komuniteteve në Kosovë të ndihen të barabartë, që askush të mos largohet nga Kosova. Në pyetjen se si janë pritur zgjedhjet e fundit në Serbi, Brovina u përgjigj se fitorja e radikalëve të Sheshelit e kthen jo vetëm Serbinë, por edhe tërë rajonin prapa. Në vijim Brovina theksoi se demokratizimi i Serbisë na intereson të gjithëve, sepse në këtë mënyrë më lehtë arrijmë zgjidhjen e statusit final, pavarësinë e Kosovës.

MUMXHIU: Një pjesë e shërbimeve spitalore barten nga Mitrovica në objektin e spitalit "Sheik Zeit" në Vushtrri

Në mbledhjen e 15 janarit të Kuvendit të Kosovës, ministrja e Shëndetësisë Resmie Mumxhiu u përgjigj në dy pyetje të deputetëve.

Duke u përgjigjur në pyetjen e deputetit Ramadan Kelmendi lidhur me atë se pse është mbyllur reparti i Kirurgjisë në Mitrovicë, ajo theksoi se para një muaji Spitali Rajonal në Mitrovicë ka vendosur që në bashkëpunim me ASHQ dhe përkrahje të Ministrisë të bëjë një pjesë të shërbimeve spitalore në objektin e spitalit "Sheik Zeit" në Vushtrri. Kjo është bërë për të ndihmuar funksionet normale të shërbimeve ambulatore në Mitrovicë. Në fillim kjo është bërë nga reparti i kirurgjisë me plan që në të ardhmen edhe disa reparte tjera, për shembull transfuzioni, varësisht nga zhvillimi i ngjarjeve të bartë aktivitetet atje. Mirëpo kjo është bërë për një periudhë të përkohshme dhe për disa arsye: shfrytëzimi i objektit që i ofron kushtet më të mira të punës; angazhimi i stafit profesional të shërbimeve të nivelit për të cilat janë përgatitur - mbi të gjitha ofrimi i kujdesit shëndetësor sekundar cilësor popullatës së rajonit . Gjithmonë të vetëdijshëm se kjo nuk është zgjidhja më e mirë dhe zëvendësim për Spitalin Rajonal të Mitrovicës së verit, që padrejtësisht nuk administrohet nga ana jonë, por kjo është zgjidhja më e mirë për momentin. Në këtë kontekst pyetja e deputetit



Ramadan Kelmendi se pse është mbyllur reparti i kirurgjisë në Mitrovicë nuk qëndron. I njëjti repart funksionon normalisht, ndërsa shërbimet 24 orëshe janë bartur përkohësisht në spitalin Sheik Zait në Vushtrri me qëllim të ofrimit të shërbimeve më të mira popullatës së rajonit .

Në vijim ajo u përgjigj edhe në pyetjen e Ismajl Kurteshit se pse në disa vende rurale nuk ka mjek, madje as infermiere. Lidhur me këtë , Mumxhiu theksoi se në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 mbi pushtetin lokal dhe në bazë të memorandumit të mirëkuptimit të nëntorit 2001, aspekti organizativ i kujdesit primar është në kompetencat e drejtorëve shëndetësorë komunalë. Mirëpo kjo nuk do të thotë se ne si Ministri e Shëndetësisë nuk duhet të kujdesemi apo nuk duhet të mirremi me këtë çështje. Së pari t'ju them se kjo është si pasojë e dhënies së specializimeve të pakontrolluara në të kaluarën. Proporcioni mjek - banor nuk është i favorshëm gjë e cila ka ndikim të madh në çështjen për të cilën jeni të interesuar.

Çka jemi duke bërë ne si Ministri në këtë aspekt? Këto ditë është nënshkruar udhëzimi administrativ lidhur me specializimet, në të cilin parashihet që çdo mjek pas kryerjes së fakultetit është i obliguar të punojë ë paku një vit, pas stazhit i cili po ashtu zgjat një vit në kujdesin parësor, që është e rëndësishë së dyfishtë, sepse në njërin anë mbulohet shërbimi nëpër ambulanca dhe punktet shëndetësore, ndërsa në anën tjetër kjo ndikon në aftësimin sa më të mirë të mjekëve të rinj.

Kur është fjala për ambulancën në Livoç, ju them se këto ditë është bërë hapja e saj, ku një infermier do të jetë çdo ditë, ndërsa mjeku do të punojë tri herë në javë.

Mitrovica nga një qendër rajonale spitalore është shndërruar në një qytet ambulantor

Deputeti Ramadan Kelmendi e vlerësoi shumë të arsyeshme dhe mjaft me rëndësi dhënien e përgjigjes së Ministrisë së Shëndetësisë për gjendjen shëndetësore në Rajonin e Mitrovicës. Por



është e pakuptueshme dhe e paarsyeshme që pyetja e parashtruar me shkrim dhe arsyetim, theksoi ai, nuk iu është dorëzuar deputetëve sot për ta parë përmbajtjen e saj dhe qëllimin e pyetjes. Megjithkëtë, natyrisht se është obligim ligjor që qytetarët të gëzojnë mbrojtjen shëndetësore adekuate, por mjerisht kjo nuk ndodh në Mitrovicë në tërësi, pra në të gjitha nivelet shëndetësore. Dhe, fatkeqësisht, kjo në Mitrovicë është edhe më e rëndë. Gjendja e mbrojtjes shëndetësore është shumë e rëndë dhe mjaft e ndërlikuar në procesin e realizimit të saj. Mitrovica, nga një qendër rajonale spitalore, është shndërruar në një qytet ambulantor. Mitrovica nga një qendër industriale është shndërruar në qytet skamnor - me 87.72% të papunëve të cilët nuk mund të kërkojnë as të drejtën më elementare të mbrojtjes shëndetësore për shkak të participimit dhe formave tjera. Është shumë e vërtetë se tani qytetarët e Mitrovicës dhe rajonit të saj, pos me probleme politike po përballen edhe me probleme të mbrojtjes shëndetësore.

>>>>

<<<<

Dhe konkretisht, me bartjen e repartit të kirurgjisë dhe të shërbimit intensiv nga Spitali i Mitrovicës në atë të Vushtrisë , 141.852 banorë të Mitrovicës dhe 86.000 të Skenderajt kanë mbetur pa mrbojtjen shëndetësore, nga se çdo ditë prej orës 13 dhe çdo ditë jopune, të shtuneve dhe të dielave atje nuk mund të ofrohet kurrfarë ndihme.

Përtej urës është Spitali Rajonal , 1500 metra në veri të urës i cili është i okupuar nga serbët dhe kemi ndarë mjete ne si Kuvend. Ku e kemi ndërgjegjen? Për kend i kemi ndarë? Ju lutem, edhe me ju polemizojmë! Dhe 14 mijë metra katrorë hapësirë spitalore nuk shfrytëzohen; nuk shfrytëzohen 760 shtretër; nuk shfrytëzohen 6 salla të operacionit; nuk shfrytëzohen 9 dhoma të kujdestarisë intensive. Dhe, ja kjo është gjendja. Ju lutem, prej 27 shtatorit në Spitalin qendror të Mitrovicës është hequr flamuri i UNMIK-ut dhe valon flamuri i Serbisë. Atje s'ka qasje asnjë shqiptar, asnjë rom, asnjë hashkali. Vetëm serbët... Dhe, të gjitha këto probleme janë të mëdha. Fundi i fundit, ka për obligim Ministria që t'i marrë të gjitha masat: politike, administrative dhe juridike që t'i kthejë punëtorët e shëndetësisë në spitalin e tyre të cilin ne po e financojmë dhe qytetarëve t'iu mundësojë mbrojtje. Vërtetë ky problem është i hapur. Unë po shoh se as këtu s'ekziston interesimi dhe po kam pengesë t'i shtroj pyetjet. Sido që të jetë, unë e kuptoj Ministrinë se ka probleme, por Mitrovica po ballafaqohet me shumë probleme, e një ndër to edhe shëndetësia. Mitrovica është shndërruar në një qytet skamnorësh dhe qytet të të sëmurësh, pa mundësi për mbrojtjen e të drejtave. Spitali në Vushtrri është dhuratë e Emirateve Arabe, kurse dhurata nuk mund të administrohet si e mendojmë ne bash lehtë dhe me të drejtë.

Ambulanca në fshatin Livoç të Epërm ka qëndruar e mbyllur gjashtë muaj

Ismajl Kurteshi theksoi se pyetja drejtuar ministres ishte: në shumë fshatra të Kosovës, edhe pse ekzistojnë ambulanca , mjekët shkojnë një ose dy herë në javë. Madje ka raste kur nuk shkojnë fare, si në rastin e fshatit Livoç i Epërm në komunën e Gjilanit - 3 kilometra larg qytetit, ku USAID-i e ka ndërtuar ambulancën e re në qershorin e vitit të kaluar, e cila është përruruar, por edhe tash, pas pesë muajve, nuk ka filluar të punojë për shkak, siç thuhet - të mungesës së mjekëve dhe infermierëve. Konsideroj se problemet e kësaj natyre kërkojnë edhe angazhimin e Ministrisë suaj. Unë e di që shëndetësia primare i takon komunave, por mendoj se Ministria nuk mund të jetë indiferente në këto raste, të cilat janë shumë të ndieshme, prandaj konsideroj se do të duhej të intervenonte në të gjitha këto raste. Ambulanca ka qëndruar mbyllur gjashtë muaj dhe është hapur më 5 janar, para dhjetë dite, që do të thotë është një neglizhencë e madhe. Probleme në shëndetësi ka edhe me specialistët, të cilët një pjesë të madhe të orarit të punës e kalojnë në ordinaanca private, prandaj ju kisha lutur që Ministria juaj të kujdeset më shumë, meqë shëndeti është vërtetë çështje për të cilën do të duhej të kemi të gjithë deputetët durim, ndërsa Ministria juaj më shumë punë në këtë drejtim.



Rinia të marrë pjesë në vendimmarrje

Të kultivohen e vërteta dhe t'u thuhet "stop!" antiolerave. Rekomandimet e rinisë do të gjejnë shqyrtim në Kuvendin e Kosovës

Shqetësimet e rinisë së Kosovës, krijimi dhe respektimi i vlerave të mirëfillta nga gjeneratat e reja, si dhe hapja e përhershme e Kuvendit të Kosovës për problemet e rinisë, ishin temat të cilat i biseduan përfaqësuesit e Parlamentit Rinor të Kosovës me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci. Kryetari i Parlamentit Rinor të Kosovës, Ervin Ibarahimi, pasi e ka njoftuar kryeparlamentarin Daci me arsyet e themelimit të këtij asociacioni dhe me synimet largvajtëse të tij, ka përshtuar punën për strukturimin e PRK-së dhe ka kërkuar mbështetjen institucionale të Kuvendit të Kosovës. Jeni të mirseardhur në seancat parlamentare të Kuvendit, mund të ndihmoni në përgatitjen e legjislacionit për çështjet e rinisë dhe të na e tërheqni vëmendjen për problemet që ju mundojnë, i ka thënë profesor Daci udhëheqjes së PRK-së. Ai i ka këshilluar përfaqësuesit e Parlamentit Rinor të Kosovës që të bëjnë më shumë për vlerat e vërteta dhe t'u thonë "stop!" antiolerave; të mos ndalen në kërkesat e drejta dhe të ngulmojnë për përparime në universitet. Përfaqësuesit e PRK-së kanë shprehur interes për pjesëmarrjen e rinisë në vendimmarrje dhe janë zotuar se shqetësimet e rinisë do t'i bartin në Kuvend të Kosovës nëpërmjet të Komisionit parlamentar për rini dhe sport.

U përrurua faqja e Kuvendit të Kosovës në internet

Për një transparencë të punës parlamentare dhe për kontakt më të mirë me media

Në prani të gazetarëve që e ndjekin profesionalisht punën e Kuvendit të Kosovës, të përfaqësuesve të Departamentit për Demokratizim të OSBE-së dhe të përgjegjësve të strukturave të brendshme të Kuvendit, sot Zyra për Marrëdhëne me media dhe publikime e përruroi faqen e Kuvendit të Kosovës në Internet. Në këtë faqe (WWW.Assembly-Kosova.org) gazetarët dhe të interesuar të tjerë do të gjejnë lajme për aktivitetet e Kuvendit të Kosovës, materiale për përbërjen e Kuvendit, biografitë e shkurtëra të deputetëve, grupet parlamentare, komisionet parlamentare, ligjet e shpalluara, orarin e takimeve etj. Projektin e ka financuar Zyra për Demokratizim të OSBE-së, bartës i projektit ka qenë, Dardan Veliu, kurse përgatitjen teknike të faqes dhe dizajnimin e ka bërë kompania profesionale "Rrota Interactive".



Minatorët e "Trepçës" në sallën e Kuvendit të Kosovës